

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 45.1 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 6.3 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe Organeve të Tij, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

### Iu f t o n

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **25 qershor 2020 (e enjte) me fillim në ora 10:00. Mbledhja do të mbahet në objektin e shkollës së mesme - Gjimnazi "Eqrem Çabej" në Vushtrri në njërën nga sallat.**


Për këtë mbledhje propozohet ky:

### **R E N D I T E**


1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja urgjente e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më 26 mars 2020;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 28 maj 2020;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2021 – 2023;
4. Shqyrtimi i Draft-rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë (**shqyrtimi i dytë**);
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e panelit përzgjedhës, për zgjedhjen e anëtarëve të komiteteve konsultative;
6. Shqyrtimi i Informatës rreth procedurës së legalizimit të objekteve;
7. Të ndryshme.

***Bashkëngjitur me ftesë iu dërgojmë rekomandimet e KPF-së dhe materialet për të gjitha pikat e rendit të ditës.***

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUČITRN

<b>PËR/ZA/TO:</b>	Kuvendin e komunës
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Nasuf Aliu Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	Sekretarisë së kuvendit
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 12.06.2020

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 54, paragrafit 5 të Statutit të Komunës dhe nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 5 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 03/2014 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2020 ka shqyrtuar disa materiale dhe nxori këtë rekomandim:

1. Shqyrtimi i Informatës rreth procedurës së legalizimeve.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL**  
**NGA MBLEDHJA URGJENTE E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË,**  
**MBAJTUR MË 26 MARS 2020**

*Mbledhja është mbajtur në objektin e shkollës së mesme, Gjumnazi "Eqrem Çabej" në Vushtrri, duke filluar në orën 16:40.*

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Arta Ymeri, Basri Menxhiqi, Bahrije Ademi Murati, Fatmire Saraçi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Faton Shabani, Gresa Muli, Habibe Gërzhaliu, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Miljan Bojković, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Nurtene Çerkezi-Gyshinca, Sajdie Bajgora, Selim Rrustemi, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Safet Idrizi, Melihate Basholli-Latifi, Suzana Sylja, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

**Munguan:** Ali Januzi, Hysni Gërguri, Fitim Halili dhe Gentiana Rama.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z.Xhafer Tahiri dhe nënkryetari i komunës z. Besim Muzaqi, drejtorë të drejtorive komunale dhe zyrtarë kompetent komunal.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - në emër të grupit kuvendar të PDK-së lidhur me pandeminë Corona Virus - covid-19, dëshirojmë të shprehim gatishmërinë tonë për kontribut pozitiv në luftimin e kësaj lufte të egër me një armik të padukshëm që po kalon Kosova e qyteti ynë, si dhe gati të gjitha vendet e globit. Ne konsiderojmë se qeveria komunale ka vepruar drejt dhe me kohë duke ndërmarrë hapa konkret, sidomos duke paralajmëruar në kontinuitet qytetarët dhe duke dhënë instruksione konform shkallës së rrezikut. Qeveria komunale në zbatim të vendimit të Qeverisë së Kosovës nr.01/07 dhe me rekomandim të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi më datë 12 mars 2020 ka themeluar shtabin komunal anti Covid-19. Ky shtab konsideroj se ka kryer me përkushtim dhe përgjegjësi punën e vet në menaxhimin e situatës, por konsideroj gjithashtu se ka hapësirë që edhe më mirë të funksionalizohet ky shtab, andaj kundrejt kësaj ne kemi vërejtje dhe konsiderojmë se pjesë e shtabit është dashtë të jenë edhe opozita së paku me dy anëtarë, jo për të marrë ndonjë primat apo privilegj, por thjesht për faktin se jemi grupi më i madh kuvendar dhe konsiderojmë se do kishte pas mundësi të kontribuojmë në ngritjen e performances së shtabit komunal anti covid-19. Sidoqoftë ne do e përkrahim punën e shtabit në vazhdimësi dhe jemi në dispozicion 24 për të bashkëpunuar dhe për të dhënë kontributin tonë në të mirë të qytetarëve, kurse pjesëmarrja jonë në shtab mbetet në përgjegjësinë e kryetarit të komunës. Ne në vazhdimësi kemi përcjell dhe u kemi dhënë përkrahje organeve qendrore dhe

lokale në ndërmarrjen e masave preventive, por ne si kuvend sot do të diskutojmë lidhur me masat anti Covid-19 në nivel komune dhe shqyrtimin e propozim-vendimit për rialokimin-transferin e mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale në kategorinë mallra dhe shërbime pika 1, si dhe pika 2 Shqyrtimi i propozim-vendit për ndarjen e mjeteve financiare për blerjen e artikujve të ndryshëm për parandalimin dhe mbrojtjen nga pandemia corona virus apo covid – 19. Sipas propozim-vendimit vlera totale e propozuar për rialokim është 100.000,00€, ne sigurisht që e përkrahim këtë propozim- vendim, por propozimi i grupit kuvendar është që të dyfishohet kjo vlerë sepse nevojat për përkrahje janë shumë të mëdha andaj propozojmë që kjo vlerë të ndryshohet dhe të votohet transferi në vlerë prej 200.000,00€, duke dyfishuar pozicionet e propozuara 100.000.00€, propozoj të transferohen nga kodi 41424 -Ndërtimi i rrugëve në këtë kod kemi 470.000,00€ dhe pas transferit mbeten 370.000,00€. Gjithashtu kemi edhe Fondin rezervë të alokuar për Komunën Vushtrri nga Qeveria e Kosovës që mund ta përdorni në rast përkeqësimit. Propozimi jonë kërkon të përkrahjet edhe nga qeveria komunale, si dhe nga të gjithë deputetët sepse siç e dini pandemia tani është në fazën e saj kritike të përhapjes dhe fatkeqësisht ka prekur edhe qytetarë të komunës sonë e që në këtë rast japim komplimente në mënyrën e mbikëqyrjes me kohë dhe identifikimin e izolimit e këtij rasti nga ana e shtabit komunal dhe stafit mjekësor komunal, por komplimente e lëvdata edhe për Policinë e Kosovës dhe të gjithë akterët që kanë kontribuar e po vazhdojnë të kontribuojnë në këtë drejtim. Të nderuar, ne e dimë që gjendja sociale e një pjese bukur të madhe të qytetarëve tanë ishte e rëndë edhe para se të vetizoheshin, tani kjo situatë është rënduar edhe më shumë, ta keni parasysh se një pjesë bukur e madhe e qytetarëve kanë jetuar nga të hyrat ditore që kanë punuar, në sektorin privat një pjesë e tyre nuk do të ketë mundësi t'i paguajë pagat në mungesë të aktivitetit të tyre biznesor e të mos flasim edhe për kategoritë që mezi mbijetojnë me social, andaj dyfishimi i kësaj ndarje buxhetore konsideroj se është i pashmangshëm. Gjithashtu i propozoj kryetarit dhe qeverisë komunale që menjëherë të adresojë kërkesa në nivel qendror për përkrahje financiare për qytetarët tanë në mënyrë që ta tejkalojmë këtë situatë. Gjithashtu ftoj të gjithë njerëzit e vullnetit të mirë të tregojnë solidaritet, i cili është shumë i nevojshëm për mbijetesën e një pjese të shoqërisë sonë.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-** pakoja ekonomike e Komunës së Vushtrisë, konsideroj se është në rregull, duke filluar nga: Propozim-vendimi për lirimin nga pagesat dhe taksa e qirasë komunale për pronat e dhëna në shfrytëzim dhe shfrytëzim të Hapësirave Publike në qytet. Propozim-vendimi për lirim nga pagesa e tarifave në institucionin për edukimin dhe arsimimin parashkollor publik në Komunën e Vushtrisë, si dhe Propozim-vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për klubet sportive Të tria këto Propozim-vendime do ti votoj, por jo edhe një Propozim-vendim, gjoja për iniciimin e studimit mbi ndikimin e Covid-19 në ekonominë formale e jo formale në Komunën e Vushtrisë siç e quani ju për masat e rimëkëmbjes ekonomike pas pandemisë. Më thuani kush po iu pengon ta bëni një studim të tillë, fundi i fundit qytetarët ua kanë dhënë besimin të qeverisni e edhe të bëni studime të tilla, pse keni nevojë të kërkoni nga Kuvendi i Komunës për një iniciim siç e quani ju. Vazhdoni ta menaxhoni situatën pandemike, fati ka dashtë që nuk kemi shpërthim të virusit, sepse qytetarët tanë kanë treguar se janë shumë të disiplinuar dhe po i respektojnë masat e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, pa dashtë ta mohoj edhe punën që po bëni si Shtab Emergjent. Pra, sa i përket këtij Propozim-vendimi, konsideroj se nuk është asgjë tjetër përveç se një arsye për rrjetet sociale. Unë mendoj se ju duhet t'a bëni një analizë të detajuar se çfarë ndikimi ka pasur Covid-19 në secilin biznes të Komunës, e pastaj të vini në kuvend me një analizë të tillë e të shohim pastaj çfarë mund të bëjmë. Ndoshta do të paraqitet nevoja për ndërhyrje në Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023. Nuk

ka nevojë askush të fshehët pas pandemisë që pastaj edhe mund të bëhen keqpërdorime, jemi këtu për të parë transparencën ashtu siç po proklamohet.

**Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit**-në emër të grupit kuvendar të LVV-së e përkrahi propozimin për rritjen e mjeteve financiare dhe bëri apel që kuvendi të shkojë direkt në votim, duke i shmangur diskutimet.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit** - në emër të grupit kuvendar të LDK-së e përkrahi propozim-vendimin për rialokimin e mjeteve financiare të komunës dhe propozoi që shtabit emergjent t'i bashkëngjitet edhe një pjesëtar i komunitetit farmaceutik. Pastaj ai pyeti se si janë duke funksionuar qendrat e mjekësisë në komunën tonë, sidomos ato nëpër fshatra, pastaj komuna a ka kontraktuar kompani për dezinfektimin e objekteve publike ku frekuentojnë qytetarët, në veçanti u ndal tek dezinfektimi i objektit ku janë të vendosura shoqatat e dala nga Lufta e UÇK-së ku janë të vendosura edhe një mori shoqatash tjera dhe në atë objekt kemi frekuentim të madh të qytetarëve.

**Lutfi Gërguri, drejtor i DBF-së** - pasi i përshëndeti të pranishmit, sqaroi se shuma e mjeteve financiare të shtuara, propozoi që të alokohen 50,000.00 € nga projekti “ndërtimi i tregut për prodhues vendorë”, ndërsa 50,000.00 € tjera nga projekti ndërtimi i rrugëve lokale.

**Xhafer Tahiri, kryetar i Komunës së Vushtrrisë** - njoftoi kuvendin se komuna jonë në saje të gjurmimit ka rezultuar se është prekur nga pandemia e quajtur covid-19, ku dy qytetarë kanë dalë pozitiv me këtë virus pas testeve të bëra nga personeli shëndetësor, ndërkohë që janë gjurmuar të gjitha kontaktet e mundshme. Në vazhdim ai apeloj tek anëtarët e kuvendit që me një duartrokitje pesë minutash t'i nderojmë punëtorët shëndetësor, policët, inspektorët dhe punëtorët e maketeve për punën e tyre që po bëjnë në kohë pandemie. *Në vazhdim kuvendi me duartrokitje pesë minuta nderoi këto kategori të shoqërisë.* Pastaj ai njoftoi se nga data 26 mars ekipet e QKMF-së së Vushtrrisë, kanë ofruar asistencën e tyre në pikën kufitare në Jarinjë. Tutje ai falënderoi ekipet komunale, shtabin emergjent, drejtorët, policët, punëtorët dhe të gjithë qytetarët për përgjigje pozitive në respektimin e masave për parandalimin e kësaj pandemie, si dhe për solidaritetin e treguar nga të gjithë. Ai bëri thirrje që të përmbahemi nga komentet lidhur me të prekurit nga corona-virusi. Uroj që të mos kemi viktimë në njerëz nga ky virus dhe që kjo gjendje të tejkalohet me sa më pak pasoja. Tutje ai njoftoi se komuna ka ndërmarrë të gjitha masat për parandalimin e kësaj epidemie, ku është bërë dezinfektimi i objekteve publike dhe me përpikëri po zbatohen rekomandimet e IKSHPK-së, po ashtu janë dezinfektuar objektet kolektive dhe ashensorët, bizneset janë urdhëruar që bukën ta shpërndajnë në formë të ambalazhuar. Ai ceku se për shkak të restriksioneve ekonomike gjendja sociale e qytetarëve është vështirësuar dhe kësajsoj kemi rritje të numrit të qytetarëve që kanë kërkuar asistencë sociale. Në këtë kontekst për zbutjen e kësaj gjendjeje kanë kontribuar shumë donatorë si: viva fresh, interex, bashkësia islame, Kryqi i kuq e shumë akterë tjerë me pako ushqimore e higjienike kur deri në momentin që po flasim janë ndihmuar afër 600 raste me asistencë sociale dhe familje tjera me gjendje të rënduar ekonomike. Pastaj njoftoi se ka plan që bashkë me qeverinë qendrore të ndërmarrë masa për rimëkëmbjen ekonomike, duke investuar afër 10,000.000 € për bizneset e vogla dhe të mesme në formë të subvencionimit të kamatave për këto biznese. Ideja është që të krijohet burim financiar për çdo biznes të Vushtrrisë për të zhvilluar dhe rritur aktivitetin ekonomik. Tutje falënderoi DKA-në dhe Ministrinë e Arsimit për organizimin e mësimit online dhe kërkoi angazhim nga të gjithë prindërit për ofrimin e ndihmës në mësimet për fëmijët e tyre. Mandej ai u zotua se në shtabin emergjent komunal do të përfshihen edhe propozimet e bëra nga opozita dhe anëtarë tjerë të kuvendit do të bëhen pjesë e shtabit emergjent. Sa i përket prokurimit publik, ceku se KRPP-ja i ka lejuar komunave që të shfrytëzojnë kontratat e negociuara me operatorët ekonomik për



furnizim me ushqim dhe pako tjera sanitare si rezultat i rëndimit të gjendjes ekonomike të qytetarëve. Në fund ai bëri thirrje për unitet politik për luftimin e virusit të padukshëm pandemisë covid-19.

**Sylejman Mehulli, drejtor i DSHPS-së** - sqaroi se Komuna e Vushtrrisë, fatmirësisht e ka pasur të kontraktuar shërbimin e DDD-së deratizim, dezinfektim dhe dezinfektim, dhe kjo e ka lehtësuar shumë punën në dezinfektimin e objekteve publike dhe atyre kolektive publike, krejt kjo me qëllim të prerjes së rrugës të virusit corona. Në fund ai bëri thirrje për unitet politik përtej agjendave ditore politike, duke e bërë kështu top prioritet shëndetësinë e komunës, dhe veçanërisht intensifikimin e përpjekjeve të përbashkëta për luftimin e pandemisë covid-19.

*Në fund të diskutimeve lidhur me rendin e ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoi këtë:*

### **R E N D I T E**

1. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rialokimin-transferimin e mjeteve financiare nga kategoria e investimeve kapitale në kategorinë mallra dhe shërbime;
2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për blerjen gjërave të ndryshme për parandalimin dhe mbrojtjen nga pandemia e njohur si corona-virus apo Covid -19.
3. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rialokimin-transferimin e mjeteve financiare nga kategoria e investimeve kapitale në kategorinë mallra dhe shërbime

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:*

1. Me këtë vendim bëhet transferimi i mjeteve financiare nga fondi dhjetë (10), në kuadër të programit Infrastruktura publike me kod 18184, nga kategoria investime kapitale me kod të projektit 47826 në kategorinë mallra dhe shërbime në shumën prej tridhjetë mijë euro (30.000.00 €).

2. Nga fondi (21), bëhet transferimi i mjeteve financiare në kuadër të programit Infrastruktura publike me kod 18184, nga kategoria investime kapitale me kod të projektit 47826 në kategorinë mallra dhe shërbime në shumën prej njëzet mijë euro (20.000.00 €).

3. Nga fondi dhjetë (10), bëhet transferimi i mjeteve financiare në kuadër të programit Infrastruktura publike me kod 18184, nga kategoria investime kapitale me kod të projektit 90226 në kategorinë mallra dhe shërbime në shumën prej tridhjetë mijë euro (30.000.00 €).

4. Nga fondi dhjetë (10), bëhet transferimi i mjeteve financiare në kuadër të programit Infrastruktura publike me kod 18184, nga kategoria investime kapitale me kod të projektit 47838 në kategorinë mallra dhe shërbime në shumën prej dhjetë mijë euro (10.000.00 €).

5. Nga fondi dhjetë (21), bëhet transferimi i mjeteve financiare në kuadër të programit Infrastruktura publike me kod 18184, nga kategoria investime kapitale me kod të projektit 47838 në kategorinë mallra dhe shërbime në shumën dyzet mijë euro (40.000.00 €)

**6. Nga fondi dhjetë (10), bëhet transferimi i mjeteve financiare nga Programi Planifikimi Urban dhe Inspeksioni me kod 66425 në Programin Infrastruktura publike me kod 18184, nga kategoria investime kapitale me kod të projektit 49579 në kategorinë mallra dhe shërbime në shumën prej njëzet mijë euro (20.000.00 €).**

**7. Nga fondi dhjetë (10), bëhet transferimi i mjeteve financiare nga Programi Planifikimi Urban dhe Inspeksioni me kod 66425 në Programin Infrastruktura publike me kod 18184, nga kategoria investime kapitale me kod të projektit 41424 në kategorinë mallra dhe shërbime në shumën prej pesëdhjetë mijë euro (50.000.00 €).**

**8. Shuma totale e mjeteve financiare të komunës, të cilat transferohen nga kategoria e investimeve kapitale në kategorinë mallra dhe shërbime, është në vlerë prej dyqind mijë euro (200,000.00 €).**

**9. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë dhe nënshkrimit nga ana e kryesuesit të kuvendit.**

**2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për blerjen gjërave të ndryshme, për parandalimin dhe mbrojtjen nga pandemia e njohur si corona-virus apo Covid -19. Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1. Nga buxheti i komunës – kategoria mallra dhe shërbime, lejohen mjete financiare në shumë prej 200,000.00 € (dyqind mijë euro), për financim të masave dhe veprimeve, të cilat duhet të ndërmerren nga Komuna e Vushtrrisë në parandalimin e përhapjes së COVID-19 me qëllim të mbrojtjes së popullatës nga kjo pandemi dhe për çështje tjera si në vijim:**

**1.1 Blerjen e mjeteve mbrojtëse, barnave dhe pajisjeve të nevojshme shëndetësore për punëtorët shëndetësorë, administratës së komunës, mjeteve dezinfektuese dhe çdo gjë tjetër që do të jetë e nevojshme për parandalim dhe mbrojtje të kësaj sëmundjeje.**

**1.2 Blerjen e pakove sociale (pako ushqimore dhe higjienike) për familjet në gjendje të rëndë sociale, në vlerë prej 50.00 € (pesëdhjetë euro) për familje.**

**2. Mjetet financiare në shumën e cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi të sigurohen nga njësitë buxhetore të komunës, në të cilat ka mjete të mjaftuara për këtë qëllim.**

**3. Shfrytëzimi i këtyre mjeteve të bëhet konform procedurave të caktuara ligjore, si dhe konform vendimeve të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, për masat të cilat duhet të ndërmerren për mbrojtjen e popullatës, bazuar në rrethanat e krijuara nga rreziku i infektimit dhe përhapjes së COVID-19 në Kosovë.**

**4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe njësitë tjera buxhetore të komunës nga të cilat do të bëhet sigurimi i këtyre mjeteve.**

**5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë dhe nënshkrimit nga ana e kryesuesit të kuvendit.**

**Mbledhja përfundoi në ora 17:20.**

**Bastri Duraku**

**Nasuf Aliu**

---

**Procesmbajtës**

---

**Kryesues i Kuvendit**





REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL**  
**NGA MBLEDHJA E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË,**  
**MBAJTUR MË 28 MAJ 2020**

*Mbledhja është mbajtur në objektin e Shkollës së Mesme Gjimnazi “Eqrem Çabej” në Vushtrri, duke filluar në orën 14:20.*

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Abdullah Vojvoda, Ali Januzi, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Arta Ymeri, Basri Menxhiqi, Bahrije Ademi Murati, Fatmire Saraçi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Faton Shabani, Fitim Halili, Gresa Muli, Gentiana Rama, Habibe Gërxhaliu, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Miljan Bojković, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Nurtene Çerkezi-Gyshinca, Sajdie Bajgora, Selim Rrustemi, Shkëlzen Feka, Safet Idrizi, Melihate Basholli-Latifi, Suzana Syla, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

**Munguan:** Hysni Gërguri, dhe Shpëtim Zhegrova.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë prezent 33 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z.Xhafer Tahiri dhe nënkryetari i komunës z. Besim Muzaqi, drejtorë të drejtorive komunale dhe zyrtarë kompetent komunal.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit** - pasi hapi mbledhjen, njoftoi se agjenda e kësaj mbledhjeje është vazhdim nga mbledhja e muajit mars, e cila nuk kishte mundur të mbahet si rezultat i përhapjes së pandemisë covid-19. Andaj njoftoi se kjo mbledhje është mjaft e ngarkuar pasi kemi edhe pika tjera që do të futen në rend të ditës.

**Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit** - përsëriti kërkesën e saj për futje në rend të ditës të propozim-vendimit për lirim nga pagesa e taksës për mbeturina për familjet me asistencë sociale, nga data 1 mars deri me 31 dhjetor 2020. Ndërsa kërkoi që pika për ndarjen e dekoratave, të renditet si pikë e tretë e rendit të ditës.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - kërkoi nga drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, të sqarojë koston financiare të vendimit për lirim nga taksat për shërbimet e mbeturinave për familjet me asistencë sociale.

**Refik Maloku, drejtor i DSHP-së** - paraqiti sqarime lidhur me propozim-vendimin për lirimin nga taksa e mbeturinave ku njoftoi se kostoja financiare vjetore për lirimin nga këto obligime është 72,000.00 €.

**Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit** - adresoi çështjen e pagës jubilarë, pagesën e shujtës dhe shpenzimeve të udhëtimit për mësimdhënësit e Komunës së Vushtrrisë, ku vlerësoi se Ministria e Financave pas përgjigjes negative që ka dhënë lidhur me përmbushjen e këtyre obligimeve, shumica e mësimdhënësve gjatë vitit të kaluar kanë ngritur procese gjyqësore për realizimin e të drejtave të tyre ligjore. Ajo çka është shqetësuese është fakti i dëmtimit të buxhetit të komunës, nga këto pagesa, por edhe rritja e shpenzimeve juridike qoftë për mësimdhënësit e po ashtu edhe për komunën. Duke marrë për bazë numrin afër 1000 mësimdhënës që do t'i realizojnë këto të drejta, shuma e mjeteve të shpenzuara për shërbime juridike (avokat dhe përmbarues) shkon afër 200, 000.00 €. Në këtë kontekst vlerësoi se pasi që gjysma e mësimdhënësve nuk kanë ushtruar padi për realizimin e këtyre të drejtave, është e udhës që DKA, të iniciojë kërkesën në Ministrinë e Financave dhe Transfereve për përmbushjen e këtyre obligimeve.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - duke iu referuar parafolësës, ceku se në bazë të informatave që posedon rreth 628 punëtorë të arsimit kanë fituar kontestet gjyqësore ndaj komunës, lidhur me pagat jubilarë dhe shpenzimet tjera, prej tyre 377 i kanë marrë mjete financiare, të cilat iu takojnë sipas ligjit në formë të ekzekutimit përmbarimor, ndërsa për 251 mësimdhënës tjerë komuna ka ushtruar ankesë e cila veç sa e vonon gjykimin, porse humbja e kontestoi nga ana e komunës është pothuajse e sigurt. Kësaj kur ja shtojmë faktin se janë edhe 400 punëtorë tjerë arsimor që do të ushtrojnë padi, atëherë kjo do të jetë një barrë e rëndë për buxhetin e komunës. Duke marrë për bazë këtë situatë jo të favorshme për komunën, atëherë duhet që qeveria komunale së bashku me kuvendin të gjejnë një zgjidhje ligjore, duke lidhur ujdin me punëtorët e arsimit ashtu që të shmangim shpenzimet gjyqësore që lidhen me taksat gjyqësore dhe shpenzimet përmbarimore.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** - në adresimin e tij para kuvendit njoftoi se këto vendime gjyqësore kanë ardhur si rrjedhojë e lidhjes së një kontrate mes MASHT-it dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit në vitin 2017. Tutje shtoi se këto të drejta dhe obligime nuk janë përmbushur që nga viti 2017 kur ka qeverisur PDK-ja, andaj kjo ka mbetur barrë për komunën. Prandaj punëtorët e arsimit janë organizuar përmes sindikatës dhe i kanë realizuar të drejtat e tyre ligjore përmes padive gjyqësore. Pastaj shtoi se është i dhimbshëm fakti i rritjes së shpenzimeve sidomos ato gjyqësore që kanë të bëjnë me përpilimin e ankesës, por premtimi i DKA-së dhe kryetarit të komunës që me pagën e dhjetorit të viti 2019 të dalin edhe pagesa e pagës jubilarë dhe shujtës, por kjo gjë nuk është realizuar. Të drejta ligjore nga kontrata janë realizuar për 600 mësimdhënës dhe punëtorë tjerë, ndërsa 400 të tjerë presin që t'i realizojnë këto të drejta. Duke u bazuar në vendimin e inspektoratit të punës ku thuhet se DKA-ja e Komunës së Vushtrrisë, pagesën e shujtave në shumën mujore prej 42 € duhet ta ekzekutojë përmes sistemit të pagave për muajt në vijim derisa të ekzistojnë kushtet ligjore. Andaj në bazë të kësaj komuna ka obligim që të përmbush këto detyrime ndaj mësimdhënësve sepse këta të fundit i kanë realizuar këto të drejta vetëm për afatin kohor prej 18 prillit 2017 e deri me 15 korrik 2019 dhe në bazë të kësaj del se DKA i ka borxh mësimdhënësve mbulimin e këtyre shpenzimeve edhe për afër një vit kalendarik sa i përket shujtave dhe shpenzimeve të udhëtimit konform kontratës kolektive. Lidhur me këtë ai pyeti DKA-në se a do t'u paguajë mësimdhënësve shujtat, shpenzimet e udhëtimit dhe pagat jubilarë për periudhën nga data 15 korrik 2019 e deri më sot si dhe a do të bëjë pagesën edhe për mësimdhënësit, të cilët nuk kanë ushtuar padi sepse shumë prej tyre nuk kanë besuar që kjo çështje do të aprovohet në formë pozitive për ta.

**Afrim Namani, drejtor i DKA-së** - në referimin e tij para kuvendit, falënderoi anëtarët e kuvendit për angazhimin e tyre për ta gjetur një zgjidhje për pagat jubilarë dhe shpenzimet tjera më qëllim që të mos dëmtohet buxheti i komunës. Tutje njoftoi se DKA në vitin e kaluar nga mjetet financiare që kanë mbetur në suficit nga kategoria e pagave dhe mëditjeve, drejtoria ka nxjerr një listë për këto shpenzime për të gjithë mësimdhënësit aktiv për pagat jubilarë ku vlera totale e këtyre shpenzimeve ka qenë rreth 170,000.00€, kjo listë është dërguar në Ministrinë e Financave, por që kjo nuk e ka bërë ekzekutimin. Në këto rrethana drejtoria nuk mund të bëjë pagesa, edhe pse detyrimet dalin nga kontrata kolektive e cila e ka fuqinë e ligjit, pasi që bazohet në Ligjin e Punës, por duhet kuptuar fakti se edhe Ligji i Buxheti është ligj i aprovuar nga Kuvendit i Kosovës. Në këtë kontekst ai njoftoi se janë duke u angazhuar me të gjitha kapacitetet që kanë që këto mjete të rimburësohen nga niveli qendror e ndoshta për këtë do të përdoren edhe mjete juridike siç është padia gjyqësore. Pastaj ai shtoi se është e dhimbshme që po shkaktohen të gjitha këto shpenzime si për mësimdhënësit ashtu edhe për komunën, por ceku se mësimdhënësit janë në të drejtën e tyre ligjore. Në fund tha se vazhdimisht kanë kërkuar nga Ministria e Financave që të parashihet linjën buxhetore për mbulimin e këtyre obligimeve, por që një gjë e tillë nuk ka ndodhur.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - tha se komuna është angazhuar me të gjitha kapacitetet dhe ka futur në planifikim buxhetor shpenzimet që dalin nga kontrata kolektive për mësimdhënësit, por që kjo nuk është lejuar dhe realizuar nga Ministria e Financave. Ajo se çfarë ka ndodhur është që përmes përmbaruesit janë marrë rreth 600, 000.00 € nga investimet kapitale për këtë qëllim dhe kjo vlerë vetëm sa do të rritet. Punëtorët arsimor janë në drejtën e tyre dhe këtë nuk mund ta mohojë askush. Ai njoftoi qytetarët se në investime kapitale komuna është dëmtuar për afro 1,000.000 € për mbulimin e shpenzimeve për mësimdhënësit që burojnë nga kontrata kolektive. Ajo se çfarë është duke u tentuar përmes lobimit në Asociacionin e Komunave të Kosovës, është që të gjitha komunat të ushtrojnë një padi ndaj Qeverisë së Kosovës, për rimburësimin e këtyre mjeteve financiare. Ai sqaroi se bazuar në ligjet pozitive, arsimi është kompetencë e deleguar e komunave dhe që kontrata kolektive nuk është nënshkruar nga komuna, por nga ministria e linjës, kurse dëmi iu është shkaktuar komunave, respektivisht qytetarëve të komunave të Kosovës e në këtë rast edhe Komunës së Vushtrrisë. Në fund tha se kur të vjen raportit për situatën ekonomiko-financiare ju do të shihni se janë hequr projektet kapitale për shkak të mbulimit të këtyre shpenzimeve të mësimdhënëseve.

***Në fund të diskutimeve lidhur me rendin e ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoi këtë:***

### **R E N D   D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 27 shkurt 2020;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja solemne e kuvendit të komunës, mbajtur më 6 mars 2020;
3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e dekoratave dhe çmimeve tjera për nder të 17 qershorit Ditës së Çlirimit të Qytetit të Vushtrrisë;
4. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2019;
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formim të komisionit vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;

6. Shqyrtimi i Propozim–vendimit për formim të komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Punën e Kuvendit dhe Organeve të tij;
7. Shqyrtimi i Draft-rregullores për dhënien e dekoratave (**shqyrtimi i parë**);
8. Shqyrtimi i Draft-rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë (**shqyrtimi i parë**);
9. Shqyrtimi i Draft-rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të veprimtarive afariste-bizneseve në Komunën e Vushtrrisë (**shqyrtimi i parë**);
10. Shqyrtimi i Raportit vjetor i punës të Ndërmarrjes regjionale të mbeturinave “Uniteti” për vitin 2019;
11. Shqyrtimi i Projekt-planit të zhvillimit institucional i kujdesit parësor shëndetësor 2020-2024 (**shqyrtimi i dytë**);
12. Shqyrtimi i petitionit i banorëve të lagjeve: “Bregaj”, “Haradinaj”, “Shala”, “Hasani”, “Maloku” dhe “Ibrahimi”, dhe
13. Të ndryshme.
14. Shqyrtimi i Draft-rregullores për ndarjen e bursave për studentë dhe shpërblimeve për nxënës të Komunës së Vushtrrisë;
15. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit të komunës, mbajtur më 23 prill 2020;
16. Shqyrtimi i Propozim–vendimit për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e komiteteve konsultative;
17. Shqyrtimi i Propozim–vendimit për lirimin nga pagesa e takës për shërbimet e mbeturinave për familjet me asistencë sociale;

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 27 shkurt 2020

***Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit në mënyrë unanime aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 27 shkurt 2020.***

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja solemne e kuvendit të komunës, mbajtur më 6 mars 2020

***Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit në mënyrë unanime aprovoi procesverbalin nga mbledhja solemne e kuvendit të komunës, mbajtur më 6 mars 2020.***

3. Shqyrtimi i Propozim–vendimit për ndarjen e dekoratave dhe çmimeve tjera për nder të 17 qershorit Ditës së Çlirimit të Qytetit të Vushtrrisë

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - lidhur me propozim-vendimin për ndarjen e dekoratave, e përgëzoi komisionin dhe shoqatat e dala nga lufta për emrat që i kanë përzgjedhur për t’u ndarë dekorata. Ai i vlerësoi lartë emrat dhe figurat e propozuara në listën për dekorata, siç është Natyra Badivuku-Kajtazi mësuese e dalluar e cila ka dhënë kontribut të çmuar edhe në kohën e okupimit. Në fund tha se grupi kuvendar i PDK-së do t’i jap mbështetje të plotë listës së propozuar për dekorata pasi janë krenarë me emrat që do të nderohen.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - arsyetoi se për nder të Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë do të nderohen e vlerësohen lartë figurat eminente e të meritura të qytetit të tonë. Ai falënderoi grupin kuvendar të PDK-së për mbështetjen që i ka dhënë punës së komisionit për dekorata. Tutje ai arsyetoi çmimet apo titujt që këtë vit do të ndahen ku ceku se është evidente që titulli “Nderi i qytetit” këtë vit pa dyshim i takon QKMF-së, përkatësisht Kujdesit Parësor Shëndetësor, shërbim ky i cili ka qenë në vijën e parë të fronit në ballafaqim me pandeminë covid-19. Pastaj çmimi “Qytetar nderi” për këtë vit shkon për dy personalitete për ambasadorin Jan Braathu, i cili para se të ishte shef i OSBE-së në Kosovë, ka shërbyer si ambasador i Norvegjisë në Republikën e Kosovës dhe kontributi i tij për Vushtrrinë është i jashtëzakonshëm për shkak se Norvegjia ka financuar sistemin e adresave të rrugëve në Komunën e Vushtrrisë, po ashtu ambasada Norvegjeze ka financuar modernizimin e zyrave të Drejtorisë së Kadastrit në Komunën e Vushtrrisë. Mandej z.Halil Kastrati është një figurë unike për të cilin të gjithë e dimë punën dhe veprimtarinë e tij, por veçanërisht kontributi i tij për Komunën e Vushtrrisë është që bashkë me komunën ka ndërtuar 28 shtëpi dhe po ashtu vitin e kaluar janë dhuruar 17 banesa nga shoqata “Jetimat e Ballkanit” për familjet në nevojë të qytetit të Vushtrrisë

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - tha se personalisht nuk është kundër dy çmimeve “Qytetar nderi” për dy personalitete të cilat janë propozuar. Por në këtë rast ai përkujtoi vitin 2019 kur një anëtar i kuvendit kërkonte që të shmangej rregullorja për arsye se personalitetet të cilat ishin propozuar kishin pasur një të kaluar gati të ngjashme, kishin vepruar bashkë. Por në atë rast një subjekt politik doli aq shumë kundër sa që rregulloren komunale e quante ligj. Andaj ai as sot nuk është kundër që stafi shëndetësor të merr titullin “Nderi i qytetit” por në këtë rast pyeti se nëse veprohet kështu a shkelet rregullorja? Pastaj në vitin 2019 publikisht në mbledhjen e kuvendit ka pasur dakordancë që vitin vijues z.Idriz Asllani do të nderohet me çmimin “Nderi i qytetit” dhe tani ky premtim po shkelet. Andaj nëse dikujt ky premtim nuk i bie në mend ai direkt e propozoi z.Idriz Asllanin për titullin “Nderi i qytetit”.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - tha se deklaratimet e parafolësit të tij janë plotësisht të vërteta dhe kërkoi ndjesë që nuk i është kujtuar propozimi nga viti i kaluar për nderimin me çmimin “Nderi i qytetit” z.Idriz Asllanit, propozim të cilin ai e mbështeti dhe për këtë kërkoi pesë minuta pauzë që shefat e grupeve kuvendare të bien dakord për këtë propozim.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** - tha se në këtë rast vetëm sa dua t’i vërtetojë fjalët e z.Nezir Klinaku sepse propozimi i vitit të kaluar ka qenë që këtë vit me titullin “Nderi i qytetit” të nderohet z.Idriz Asllani. Në vitin e kaluar ka pasur ide që ky titull të ndahet përgjysmë mes tij dhe z.Idriz Asllanit, por që kishte pasur kundërshtime. Andaj në këtë rast ai e mbështet plotësisht propozimin që z.Idriz Asllanit t’i ndahet titulli “Nderi i qytetit”. Ai vlerësoi se fjala e dhënë apo premtimi duhet mbajtur dhe shtoi se kemi shumë personalitete të komunës, të cilat duhet lartësuar dhe ngritur që kanë kontribut të veçantë jo vetëm për qytetin tonë, por për gjithë Kosovën.

**Basri Menxhiqi, anëtar i kuvendit** - kërkoi që të ketë unanimitet të plotë në kuvend dhe mos të ketë kundërshtitë dhe mospajtime për propozimin e dhënë për z.Idriz Asllani që të nderohet me çmimin “Nderi i qytetit”.

*Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:*

**1. Me këtë vendim, Kuvendi i komunës për nder të “Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë”, më 17 qershor ndan këto mirënjohje:**

**1.1 Hasan Shkreli –prind i dy martirëve të lirisë Rrahim e Bukurie Shkreli;**

**1.2 Shukri/Adem- Kalludra- për kontributin e dhënë për çlirimin e vendit, veteran i luftës së UÇK-së;**

**1.3 Xhevat Imeri, prind i dëshmorit Nezir Imeri, heroit të Kosovës i cili ra heroikisht në Betejën e Opterushës në Rahovec;**

**1.4 Riza Ibra, (post-mortum) - ish luftëtar i UÇK-së, veprimtar i çështjes kombëtare;**

**1.5 Bekë Shyti, për kontributin e dhënë në fushën e shëndetësisë, specialist i mjekësisë familjare;**

**1.6 Fahrije Kllokoqi, për kontributin e dhënë në fushën e letërsisë, poete e dalluar;**

**1.7 Izet Morina, për kontributin e dhënë në lëmin e arsimit mësimdhënës i dalluar;**

**1.8 Natyra Badivuku-Kajtazi, mësimdhënëse dhe humaniste;**

**1.9 Fatmir Aliu, veteran i luftës së UÇK-së;**

**1.10 Rifat Mustafa, për kontributin e dhënë në fushën e arsimit dhe kontribut të çmuar në luftën e UÇK-së.**

**2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.**

**3. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**1. Me këtë vendim, z.Idriz Asllanit nga Komuna e Vushtrrisë i ndahet çmimi “Nderi i qytetit”, për kontributin e dhënë si veprimtar i çështjes kombëtare, pjesëmarrës në demonstratat e vitit 1981, ish i burgosur politik, si dhe për kontributin e çmuar në luftën për çlirimin e Kosovës.**

**2. Dorëzimi i këtij çmimi do të bëhet nga Kryetari i Komunës, më datë 17 qershor- “Ditën e Çlirimit të Vushtrrisë”.**

**3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.**

**4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**1. Me këtë vendim, Stafit të Kujdesit parësor Shëndetësor në Komunën e Vushtrrisë i ndahet titulli “Nderi i qytetit” për kontributin e dëshmuar, angazhimin dhe përkushtimin në punën e tyre në luftën kundër pandemisë corona virus covid-19 në Komunën e Vushtrrisë.**

**2. Titulli “Nderi i qytetit” i dorëzohet drejtoreshës të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Vushtri.**

**3. Dorëzimi i këtij çmimi do të bëhet nga Kryetari i Komunës, më datë 17 qershor- “Ditën e Çlirimit të Vushtrrisë”.**

**4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.**

**5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**1. Me këtë vendim, z.Halil Kastrati, drejtor i Shoqatës bamirëse “Jetimët e Ballkanit” i ndahet titulli “Qytetar nderi” i Komunës së Vushtrrisë, për kontributin e madh të dhënë në aspektin e humanizmit në ndërtimin dhe zgjidhjen e çështjes së banimit (ndërtimin e shtëpive, blerjen e banesave dhe ofrimin e ndihmave tjera) për familjet në nevojë në Komunën e Vushtrrisë.**

**2. Dorëzimi i këtij titulli do të bëhet nga Kryetari i Komunës, më datë 17 qershor “Ditën e Çlirimit të Vushtrrisë”.**

**3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.**

**4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**1. Me këtë vendim, z.Jan Braathu, Shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë i ndahet titulli “Qytetar nderi” i Komunës së Vushtrrisë, për kontributin e dhënë në realizimin e projektit të sistemit të adresave të rrugëve, mbështetjen e fuqishme në financimin e modernizimit të zyrave të Drejtorisë së Kadastrit dhe projekte tjera për Komunën e Vushtrrisë.**

**2. Dorëzimi i këtij titulli do të bëhet nga Kryetari i Komunës, më datë 17 qershor “Ditën e Çlirimit të Vushtrrisë”.**

**3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.**

**4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**



#### 4. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2019

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - tha se është kriter dhe standard që raportit për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese, në fund si shtojcë t'i bashkëngjitet pasqyra e detyrimeve kontingjente të komunës, në mënyrë që anëtarët e kuvendit dhe qytetarët të jenë të njoftuar për gjendjen ekonomike dhe financiare të komunës, gjegjësisht për të gjitha paditë që janë ushtruar ndaj komunës dhe të cilat në mënyrë direkte mund ta rrezikojnë gjendjen dhe qëndrueshmërinë ekonomike dhe financiare të komunës. Në këtë kontekst ai kërkoi që këto standarde të përfillen ashtu që kryetari i komunës ka obligim që në fund të këtij raporti dhe pasqyra e detyrimeve kontingjente të japë një deklaratë me shkrim ku zotohet se këto detyrime kontingjente nuk e rrezikojnë qëndrueshmërinë financiare të komunës.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - tha se pajtohet me atë që detyrimet kontingjente duhet të jenë pjesë e raportit për situatën ekonomike dhe financiare të komunës, dhe shtoi se deklaratën për qëndrueshmërinë financiare të komunës e ka nënshkruar tek pasqyrat financiare, por nëse kjo ligjërisht kërkohet edhe tek raporti, atëherë atë do ta nënshkruaj si aprovim nga ana e tij.

*Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoi Raportin për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2019.*

#### 5. Shqyrtimi i Propozim–vendimit për formim të komisionit vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** - propozoi për anëtar të këtij komisioni z.Mehdi Bejtullahun.

**Shkëlzen Feka, anëtar i kuvendit** - në emër të grupit kuvendar të LDK-së propozoi për anëtar të komisionit z.Agron Përçukun.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim formohet Komisioni vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të cekur në vendimin paraprak, përkatësisht, parcela kadastrale P-70202027-00007-0, në sipërfaqe prej 53413 m<sup>2</sup>, ZK Studime e Poshtme.

2. Përbërja e komisionit:

- 2.1 Agron Përçuku, anëtar i kuvendit;
- 2.2 Mehdi Bejtullahu, anëtar i kuvendit;
- 2.3 Adnan Lahu, ekzekutivi i komunës;
- 2.4 Miran Halili, ekzekutivi i komunës;
- 2.5 Besmir Ahmeti, shoqëria civile.

3. Anëtarët e Komisionit vlerësues në takimin e parë, me shumicë votash, zgjedhin kryesuesin i cili e kryeson komisionin.

4. Komisioni vlerësues ka mandat për shqyrtim të ofertave vetëm për pronën e cekur në pikën një (1) të këtij vendimi.

5. Detyrat dhe përgjegjësitë:

5.2 Komisioni vlerësues zbaton procedurat e ankandit publik për pronën e paluajtshme të komunës e cila jepet në shfrytëzim që nënkupton:

5.2.1 Njoftimin publik i cili zgjat 15 ditë kalendrike nga dita e publikimit;

5.2.2 Njoftimi publik publikohet në faqen zyrtare të komunës, në tabelën e shpalljeve të komunës, në vendin ku gjendet prona e komunës, e cila jepet në shfrytëzim dhe së paku në njëërën nga mediat e shkruara dhe elektronike;

5.2.3 Njoftimi duhet të përmbajë të dhënat kadastrale të pronës, lokacionin, përshkrimin e pronës, kohëzgjatjen e shfrytëzimit, formën e konkurrimit, arsyeshmërinë e interesit publik, çmimin fillestar, kërkesat për pjesëmarrje në konkurrim, kohën dhe vendin ku mbahet ankandi dhe hapja e ofertave.

5.3 Pas pranimit të ofertave Komisioni vlerësues bën vlerësimin e tyre në përputhje me kushtet e përcaktuara në njoftimin publik.

5.4 Komisioni vlerësues përzgjedh përfituesin brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e mbylljes së njoftimit publik në rastet e vlerësimit të ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër, ndërsa brenda 15 ditësh për rastet e dhënies në shfrytëzim afatgjatë.

5.5 Njoftimin për përzgjedhjen e ofertave komisioni e publikon në faqen zyrtare të komunës, si dhe të njëjtin iu dërgon palëve të përfshira në proces.

5.6 Komisioni vlerësues pas përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertën e përzgjedhur e procedon te kryetari i komunës për nënshkrim të kontratës me përfituesin.

5.7 Vendimet në komisionin vlerësues merren me shumicë të votave të anëtarëve të komisionit.

5.8 Komisioni, për punën e tij mban procesverbal të cilin e nënshkruan procesmbajtësi dhe kryesuesi i komisionit.

6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: anëtarët e Komisionit vlerësues.

7. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

6. Shqyrtimi i Propozim–vendimit për formim të komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Punën e Kuvendit dhe Organeve të tij

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - tha se rregullorja aktuale e punës së kuvendit, është e harmonizuar me LVL-në dhe statutin e komunës, dhe tani nuk e di se përse ka nevojë të bëhet ndryshimi i kësaj rregulloreje. Megjithatë propozoi z.Shpëtim Zhegrova për anëtar të komisionit.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit** - vlerësoi se ndryshimi dhe plotësimi i rregullores së kuvendit ka ardhur si rezultat i fillimit të ndryshimit të statutit të komunës dhe këto ndryshime po bëhen me qëllim të harmonizimit të këtyre dy dokumenteve.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit** - në emër të grupit kuvendar të LDK-së propozoi për anëtar të këtij komisioni z.Shkelzen Fekën.

**Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit** - në emër të grupit kuvendar të LVV-së propozoi për anëtar të këtij komisioni z.Hajriz Mustafën.

**Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore** - propozoi Albanez Tahirajn për anëtar të komisionit.

**Pas propozimeve të dhëna, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1.Me këtë vendim themelohet komisioni për përgatitje të draft-Rregullores për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për Punën e Kuvendit dhe Organeve të tij.**

**2. Përbërja e komisionit të lartcekur është si në vijim:**

**2.1 Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit, kryesues i komisionit;**

**2.2 Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit, anëtar i komisionit;**

**2.3 Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit, anëtar i komisionit;**

**2.4 Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit, anëtar i komisionit;**

**2.5 Albanez Tahiraj, zyra ligjore, anëtar i komisionit.**

**3. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të përgatisë draftin e rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për punën e kuvendit dhe organeve të tij të miratuar më 4.4.2013, dhe procedoi për shqyrtim dhe miratim në kuvend.**

**4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: komisioni i cekur në pikën 2 të këtij vendimi.**

**5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**7. Shqyrtimi i Draft-rregullores për dhënien e dekoratave (shqyrtimi i parë)**

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft- Rregullorja për Dhënien e Dekoratave e Komunës së Vushtrrisë.**

**2. Diskutimi publik fillon nga data 5 qershor 2020 dhe zgjat deri më 5 korrik 2020.**

**3. Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.**

**4. Obligohet komisioni i themeluar nga kuvendi që si hartuese i draft-rregullores në fjalë, të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet komisioni i sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin korrik 2020.**

**5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**8. Shqyrtimi Draft-rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë (shqyrtimi i parë)**

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - tha se tek neni 7, pika 7.9 dhe neni 10 i kësaj draft-rregulloreje, ku përcaktohen masat ndëshkuese, kemi përsëritje të përmbytjes së këtyre neneve. Për këtë ai vlerësoi se neni 10 janë masa ndëshkuese, të cilat janë në harmoni me ligjin, ndërsa tek neni 7 pika 9 këto zgjedhje ligjore të përcaktimit të masave ndëshkuese nuk janë në harmoni me ligjin, sepse nëse gjeneruesi i mbeturinave nuk i paguan obligimet nuk mund të ndëshkohet duke mos iu ofruar shërbime komunale nga drejtoritë gjegjëse. Andaj propozoi që masat e përcaktuara nga neni 7 pika 9 të hiqen nga rregullorja.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft- Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave e Komunës së Vushtrrisë.**

**2. Diskutimi publik fillon nga data 5 qershor 2020 dhe zgjat deri më 23 qershor 2020.**

**3. Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.**

**4. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike që si hartuese e draft-rregullores në fjalë, të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt.**

**25.4.2013. Gjithashtu obligohet drejtoria e sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin qershor 2020.**

**5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**9. Shqyrtimi Draft-rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të veprimtarive afariste-bizneseve në Komunën e Vushtrrisë (shqyrtimi i parë)**

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës të Veprimtarive Afariste-Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë.**

**2. Diskutimi publik fillon nga data 5 qershor 2020 dhe zgjat deri më 5 korrik 2020.**

**3. Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.**

**4. Obligohet Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e Komunës së Vushtrrisë që si propozues i draft-rregullores në fjalë, të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet drejtoria e sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin korrik 2020.**

**5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**10. Shqyrtimi i Raportit vjetor i punës së ndërmarrjes regjionale të mbeturinave “Uniteti” për vitin 2019**

***Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoi Raportin vjetor të punës së ndërmarrjes regjionale të mbeturinave “Uniteti” për vitin 2019.***

**11. Shqyrtimi i Projekt-planit të zhvillimit institucional i kujdesit parësor shëndetësor 2020-2024 (shqyrtimi i dytë)**

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim aprovohet Plani Zhvillimor Institucional i Kujdesit Parësor Shëndetësor 2020-2024.**

**2. Qëllimi i aprovimit të këtij plani është konsolidimi i infrastrukturës juridike me qëllim të arritjes së objektivave në drejtimin e qartë të politikave të kujdesit shëndetësor në komunë, i cili do të jetë udhërrëfyes i vlefshëm për planifikimin e aktiviteteve në Kujdesin Parësor Shëndetësor.**

**3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare dhe sektorë tjerë kompetent që i referohen këtij dokumenti.**

**4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Plani Zhvillimor Institucional i Kujdesit Parësor Shëndetësor 2020-2024 i Komunës së Vushtrrisë.**

**5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**12. Shqyrtimi i petitionit i banorëve të lagjeve: “Bregaj”, “Haradinaj”, “Shala”, “Hasani”, “Maloku” dhe “Ibrahimi”;**

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë **28 maj 2020**, ka shqyrtuar petitionin e parashtruar nga z.Sinan Maloku përfaqësues i lagjeve: Maloku, Bregaj, Haradinaj, Shala, Hasani dhe Ibrahimi për ndarjen e mjeteve financiare për financimin e projektit të ndriçimit dhe trotuarit të rrugëve në këto lagje, andaj në këtë rast, Drejtorisë së Shërbime Publike dhe Drejtorisë për Buxhet dhe Financa i parashtron këtë:

### **REKOMANDIM**

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë i rekomandon drejtorive, të sipërcekura të ndajnë mjete financiare konform mundësive financiare dhe ligjore, për financimin e projekteve të ndriçimit publik dhe shtrimin e trotuarit në rrugët e lagjeve: Maloku, Bregaj, Haradinaj, Shala, Hasani dhe Ibrahimi të fshatit Stanoc i Epërm.

*Rekomandohet që Drejtoria për Shërbime Publike, si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa, t'i zhvillojnë procedurat e akordimit të kësaj ndihme financiare konform legjislacionit në fuqi, për financimin e projekteve të lartcekura.*

**13. Të ndryshme**

a). Shqyrtimi i Draft-rregullores për ndarjen e bursave për studentë dhe shpërblimeve për nxënës të Komunës së Vushtrrisë (**shqyrtimi i dytë**)

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit** – shtroi çështjen e përcaktimit të pikëve tek përfituesit e bursave për kandidatët që përfitojnë 5 pikë në rastet kur nuk i kanë në jetë prindërit, dhe këtu dilema shtrohet se a bëhet fjalë vetëm për njërin prind, apo se pikët përfitohen vetëm në rastet kur të dy prindërit nuk janë në jetë. Për këtë ajo kërkoi që kjo pikë të sqarohet dhe të hiqen dilemat.

**Mejreme Ismajli, anëtare e kuvendit** - kërkoi që të bëhen dallime sa i përket rangimit sepse Fakulteti i Mjekësisë nuk është i nivelit bachelor, ai i stomatologjisë dhe Fakulteti Juridik është katërvjeçar.

**Afrim Namani, drejtor i DKA-së** - sqaroi se sa i përket përfitimit të pikëve për kandidatët të cilët nuk i kanë prindërit në jetë, është mendim i komisionit se këta kandidatë do t'i fitojnë pikët edhe në rastet kur vetëm njërin prind nuk e kanë në jetë. Ndërsa shtoi se edhe fakulteti me kohëzgjatje katërvjeçar është i nivelit bachelor.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoi Rregulloren për ndarjen e bursave për studentë dhe shpërblimeve për nxënës të Komunës së Vushtrrisë.*

b). Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit të komunës, mbajtur më 23 prill 2020

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit në mënyrë unanime aprovoi procesverbalin nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit të komunës, mbajtur më 23 prill 2020.*

c).Shqyrtimi i Propozim–vendimit për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e komiteteve konsultative

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1. Miratohet propozimi i Kryetarit të komunës për shpallje të konkursit për zgjedhje të anëtarëve të komiteteve konsultative të Kuvendit si në vijim:**

**1.1.Komiteti Konsultativ për Arsim, Kulturë, Fe, Sport dhe Rini (7 anëtarë);**

**1.2.Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike (7 anëtarë);**

**1.3.Komiteti Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Ambientit (7 anëtarë);**

**1.4.Komiteti Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale (7 anëtarë);**

**1.5.Komiteti Konsultativ për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore (7 anëtarë);**

**2. Kushtet dhe kriteret e konkursit duhet të jenë në përputhshmëri me nenin 8 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.**



**3. Kompensimi i anëtarëve të komitetit bëhet në pajtim me nenin 14 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.**

**4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Kryesuesi i kuvendit, Njësia e personelit dhe Sekretaria e kuvendit.**

**5. Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

ç). Shqyrtimi i Propozim–vendimit për lirim nga pagesa e takës për shërbimet e mbeturinave për familjet me asistencë sociale

**Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit** - tha se duke parë që borxhi për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave, për familjet me asistencë sociale është duke u grumbulluar, propozoi që këto familje të lirohen në formë të përhershme nga ky obligim.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - tha se në vendim duhet të specifikohet afati për të cilin vlen lirimi nga kjo pagesë.

**Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit** - tha se propozimi i grupit të saj kuvendar, ka qenë që kjo masë të ketë efekt juridik nga data 1 mars deri me 31 dhjetor 2020, kohë kjo kur është rënduar gjendja sociale e kësaj kategorie si rezultat i pandemisë covid-19.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - tha se kostoja financiare e këtij vendimi nuk është e vogël, dhe njoftoi se të gjitha këto masa lehtësuese të ndërmarra nga qeveria komunale, për lirim nga pagesat e obligimeve financiare, mendon se do të kompensohen nga Qeveria e Kosovës, sepse në të kundërtën komuna do të ketë probleme të mëdha financiare në mbulimin e shpenzimeve tjera dhe financimin e projekteve me rëndësi për qytetarët.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim lirohen nga pagesa e taksës për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave, familjet me asistencë sociale të Komunës së Vushtrrisë.**

**2. Vendimi për lirim nga obligimi i pagesës së takës për shërbimet e mbeturinave bëhet si rezultat i rëndimit të gjendje sociale të familjeve që përfitojnë nga skema sociale, si pasojë e pandemisë covid-19 e njohur si corona-virus.**

**3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.**

**4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë dhe fillon të prodhojë efekt juridik nga data 01 mars 2020 deri më datën 31 dhjetor 2020.**

**Mbledhja përfundoi në ora 16:00.**

**Bastri Duraku**

---

**Procesmbajtës**

**Nasuf Aliu**

---

**Kryesues i Kuvendit**



**REPUBLIKA E KOSOVËS**



**KOMUNA VUSHTRRI**

---

## **KORNIZA AFATMESME BUXHETORE**

**2021 - 2023**

**KOMUNA E VUSHTRISË**

## **Përmbajtja**

- I. Hyrje
- II. Deklarata e prioriteteve afatmesme
- III. Vizioni i komunës
- IV. Misioni i komunës
- V. Korniza fiskale komunale
- VI. Të hyrat komunale dhe parashikimi afatmesëm 2021-2023
- VII. Plani komunal i bashkëfinancimit sektorial me ministritë e linjës dhe donatorët
- VIII. Analiza gjinore
- IX. Informacionet sipas programeve

## I. Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore KAB, të cilën po e paraqesim është një deklaratë e prioriteteve të politikave të qeverisë që ka për qëllim orientimin e ndarjes së mjeteve buxhetore gjatë procesit të ardhshëm buxhetor. Përkrah parashikueshmërisë në procesin e buxhetit, duke siguruar se buxheti bazohet në parashikimin afatmesëm, Korniza afatmesme buxhetore miratohet në parim çdo vit nga Kuvendi Komunal. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Korniza afatmesme buxhetore, siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen e objektivave prioritare, të përcaktuara me Dokumentet strategjike dhe përditësimin e këtyre strategjive me procesin buxhetor 2021-2023

Hartimi i Kornizës afatmesme buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkorja buxhetore 2021/01 të lëshuara nga Ministria e Financave dhe Transfereve në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Korniza afatmesme buxhetore i operacionalizon prioritetet e strategjisë. Buxheti për vitin 2021 dhe projeksionet për vitet 2022 dhe 2023 do të planifikohen në nivel të programeve dhe nënprogrameve, gjithashtu planifikimi i buxhetit duhet të bëhet edhe sipas kategorive ekonomike.

Janë pesë faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB-it Komunal dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:



## II. Deklarata e prioriteteve afatmesme

Dokumentet strategjike trasojnë rrugën dhe veprimet drejt zhvillimit lokal dhe përmirësimit të kushteve të jetesës. Vushtrria, duke zgjedhur këtë rrugë, po hyn në fazën e realizimeve të synimeve për një komunë me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, me urbanizim bashkëkohor, qendër e trashëgimisë kulturore, me perspektivë të zhvillimit të turizmit kulturor dhe jetës së begatë kulturore, arsimore dhe sportive, me mbështetje direkte të zhvillimit të bujqësisë e industrisë përpunuese, përmes shtimit të investimeve dhe krijimit të një ambienti të përshtatshëm për punësim në këta sektorë. Strategjitë e Komunës fuqizojnë ngritjen e kapaciteteve qeverisëse duke përmirësuar zbatimin e ligjeve, fuqizojnë komunitetin duke krijuar klimë partneriteti me biznesin, shoqërinë civile e qytetarët, e cila do të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësim të qeverisjes lokale e rrjedhimisht edhe përdorim efektiv të aseteve komunale. Dokumentet strategjike po i përcaktojnë mekanizmat për ta bërë realitet vizionin tonë për një komunë me rritje më të lartë ekonomike dhe uljen e papunësisë në Kosovë, me administratë moderne dhe arsim të nivelit evropian. Dokumentet strategjike synojnë të ndërtojnë një baraspeshë zhvillimore në aspektin e hapësirës, të zhvillimit dhe progresit harmonik ambiental por edhe social.

Megjithatë situata e krijuar nga pandemia COVID19 ka ndikuar në rrjedhat e ekonomisë globale, ky Izolimi i Madh ka ndikuar në masë të madhe edhe në rrjedhat e ekonomisë në Kosovë në disa aspekte: si në konsum, investime, eksport, import, remitencat etj. Sa më shumë do të zgjas periudha e distancimit social apo izolimit, aq më të vogla do të jenë gjasat për rimëkëmbje ekonomike. Projektionet e rritjes reale të BPV.

Në lidhje me projeksionet e shpenzimeve buxhetore për periudhën e ardhshme afatmesme 2021-2023, janë tri elemente kyçe që organizatat buxhetore duhet të kenë parasysh. E para, që organizatat buxhetore mund të planifikojnë shpenzime brenda kufijve të dhënë vetëm pasi të mbulojnë detyrimet kontraktuale, tek pastaj hapësirën e lirë brenda kufijve mund ta shfrytëzojnë për prioritete tjera. E dyta, kufijtë buxhetor të vlerësuar me këtë dokument, mund të ndryshojnë përmes qarkores së tretë buxhetore, si rrjedhojë e ndryshimit të rrethanave makroekonomike në kuptim të daljes nga pandemia COVID 19. E treta, projeksioni i shpenzimeve në kategorinë e pagave dhe shtesave për vitin 2021 mund të pësojë ndryshim si rrjedhojë e vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese lidhur me Ligjin e Pagave në Sektorin Publik.

Komuna e Vushtrrisë shtrihet në pjesën veriperëndimore të Rrafshit të Kosovës, në zonën ku afrohen bjeshkët e Shalës dhe Çyqavicës, bri lumit “Silnica”. Vushtrria është qytet historik i njohur që nga koha bizantine ilire-romake dhe me emërtime të ndryshme. Është qendër komunale në të cilën gravitojnë 67 lokalitete të banuara, kurse territori i komunës përfshin një sipërfaqe prej 345 km<sup>2</sup>. Pozita gjeografike që ka i mundëson asaj lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Komuna e Vushtrrisë ka 69870 banorë të organizuar në 11866 ekonomi familjare.

Bizneset aktive të Komunës së Vushtrrisë llogaritet të jenë 3,790. Në kohën e fundit vërehet një trend pozitiv në hapjen e bizneseve bujqësore të cilat hapin rrugë për biznese prodhuese. Prej këtyre bizneseve kryesisht dominon tregtia me shumicë, pastaj transporti, telekomunikacioni, hotelet, restorantet, industrinë përpunuese, më pas bujqësia dhe pylltaria, si dhe veprimtari të tjera ekonomike, në funksion të ngritjes së mirëqenies së vet qytetarëve. Edhe pse disa prej tyre nuk janë aktive, këto veprimtari ekonomike punësojnë një numër të konsiderueshëm të punëtorëve. Bazuar në të dhënat e Zyrës për regjistrim të bizneseve në komunë të cilat janë marrë në ARBK, në Komunën e Vushtrrisë operojnë rreth 4,267 biznese, pjesë e konsiderueshme e tyre merren me veprimtari tregtare 36.84% , në sektorin e shërbimeve (hotele dhe restorante) 9.66% , industri përpunuese 9.56 etj. Krahasuar me vitin e kaluar vërehet një rritje e lehtë në përqindjen e aktiviteteve në bujqësi, gjueti dhe pylltari, industri përpunuese dhe një rënie gjithashtu e lehtë në tregtinë me shumicë dhe pakicë, riparim i automjeteve dhe aparateve tjera të amvisërisë

Struktura e veprimtarive ekonomike bazuar në të dhënat e marra nga ARBK

Row Labels	Vu sh t r r i
A - BUJQËSIA, PYLLTARIA DHE PESHKIMI	206
B - MINIERAT DHE GURORËT (INDUSTRIA NXJERRËSE)	4
E - FURNIZIMI ME UJË; KANALIZIMI, AKTIVITETET E MENAXHIMIT DHE TË TRAJTIMIT TË MBETURINAVE	8
F - NDËRTIMTARIA	223
H - TRANSPORTI DHE MAGAZINIMI	459
I - AKOMODIMI DHE SHËRBIMI USHQIMOR	398
J - INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI	64
K - AKTIVITETET FINANCIARE DHE TË SIGURIMIT	11
L - AKTIVITETET E PATUNDSHMËRISË	7
M - AKTIVITETET PROFESIONALE, SHKENCORE DHE TEKNIKE	93
N - SHËRBIMET ADMINISTRATIVE DHE MBËSHTETËSE	67
O - ADMINISTRIMI PUBLIK DHE MBROJTJA; SIGURIMI SOCIAL I DETYRUESHËM	1
P - ARSIMI	38
Q - AKTIVITETET E SHËNDETIT TË NJERIUT DHE TË PUNËS SOCIALE	55
R - ARTET, ARGËTIMI DHE REKREACIONI	46
S - AKTIVITETET E TJERA SHËRBYESE	207
G - TREGTIA ME SHUMICË DHE PAKICË; RIPARIMI I MJETEVE MOTORIKE DHE MOTOÇIKLETAVE	1582
D - FURNIZIMI ME RRYMË, GAZ, AVULL DHE AJËR TË KONDICIONUAR	2
C - INDUSTRIA PËRPUNUESE	319
<b>Grand Total</b>	<b>3790</b>



### **III. Vizioni i komunës**

Rajoni i Vushtrrisë ka potencial rinor i cili kërkon arsim cilësor, mbështetje të punësimit përmes rritjes së investimeve dhe mbështetjes së sektorit privat, krijim të klimës së favorshme për të zhvilluar biznes, e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë do të ndikojë në rritjen e punësimit dhe në përmirësimin e kushteve të jetesës për të gjithë qytetarët. Përmes zhvillimit dhe bashkëpunimit ekonomik rajonal, për të krijuar mundësi të barabarta dhe mirëqenie për të gjithë qytetarët e saj, të matur me infrastrukturë cilësore, mjedis të pastër dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, të cilat janë në pajtim me standardet e BE-së.

### **IV. Misioni i Komunës**

Komuna e Vushtrrisë do të zhvillojë dhe do të ngrisë mirëqenien ekonomike, sociale, kulturore dhe fizike, do të sigurojë një jetë me të mirë për të gjithë qytetarët e saj nëpërmjet këtyre shtyllave:

- Zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik
- Avancimit të arsimit dhe edukimit
- Përmirësimit të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale
- Zhvillimit të infrastrukturës dhe ruajtjes së ambientit
- Promovimit të turizmit, kulturës dhe sportit
- Rritjes së efikasitetit të administratës publike

Bazuar në dokumentet strategjike, Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2021-2023 të Qeverisë së Kosovës dhe prioritetëve bazë të saj, si dhe Qarkoren Buxhetore Komunale 2021/01 të lëshuar nga Ministria e Financave dhe Transfereve e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për tri vitet e ardhshme. Synimi i Komunës së Vushtrrisë është që të jetë qendër e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik me urbanizëm modern dhe shërbime efikase e kualitative, e integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare si një qendër e kulturës së pasur, arsimit, jetës sportive dhe synon një kualitet më të mirë të jetesës për qytetarët e saj.

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë së pari lehtësia e komunikimit, si dhe së dyti llogaridhënia. Me qëllim të përmbushjes së këtyre dytributeve, prioritetet strategjike të komunës në periudhën afatmesme janë grupuar në katër prioritete që do të mundësojnë realizimin e qëllimit të vizionit tonë për komunën.

### **Forcimi i ekonomisë komunale me mundësi për të gjithë**

Rritja e ekonomisë komunale përmes:

- Përmirësimit të standardeve të arsimit dhe edukimit cilësor;
- Mbështetjes direkte të sektorit bujqësor dhe blegtorisë;
- Mbështetjes direkte të sektorit bujqësor, pylltarisë e blegtorisë;
- Krijimit të një ambienti të favorshëm ndërmarrës;
- Mbështetjes së industrisë përpunuese;
- Promovimit të strategjisë së investimeve të huaja të diasporës dhe investimeve lokale;

## **Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve**

Krijimi dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre:

- Asistenca sociale për familjet në nevojë, pa të ardhura/të ardhura të ulëta.
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile.

## **Përmirësimi i ambientit të komunës dhe qëndrueshmëria e tij**

- Përmirësimi dhe rigjenerimi i infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriçimi publik dhe numerizimi), transporti dhe kanalizimi;
- Përmirësimi i standardeve ambientale;
- Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara.

Ndërsa prioriteti i fundit strategjik i komunës ka të bëjë me efikasitetin e brendshëm të qeverisë komunale dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët e saj.

## **Krijimi i qeverisë komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve**

Përmirësimi i shërbimeve komunale karshi qytetarëve duke u fokusuar në qasjen më të afërt dhe të lehtë të tyre në administratë përmes fushave prioritare të komunës dhe objektivat e saj për periudhën afatmesme 2021-2022 do të shoqërohen me shuma të hyrash dhe shpenzimesh në të pesë kategoritë ekonomike, të cilat do të mund të monitorohen dhe raportohen karshi arritjeve.

## **Kriteret e përgjithshme për përgatitjen e buxhetit 2021 - 2023**

Procesi buxhetor për vitet 2021-2023 ka për qëllim ndërlidhjen e planeve dhe politikat buxhetore të qeverisë me nevojat ekonomike dhe sociale të vendit. Gjatë hartimit të këtij dokumenti duhet t'i japim prioritet:

- Projekteve të cilat ndihmojnë në realizimin e objektivave të përcaktuara me dokumentet strategjike.
- Projekteve të cilat janë në vazhdimësi nga vitet paraprake;
- Të përfshijmë brenda ndarjeve buxhetore obligimet për financim të projekteve me bashkëfinancim të jashtëm;
- Të kujdesemi që të hyjmë në obligim për bashkëfinancim vetëm deri në nivelin që lejon korniza buxhetore;

Procesi i planifikimit të buxhetit duhet të përfshijë këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nënprogrameve në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël;
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës;

- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale, si dhe prezantimi tabelar mbi burimet e financimit dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2021 dhe projeksionet për vitet 2022 – 2023;
- Planifikimi i projekteve në pajtim me UA MF NR.04/209 për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale,

Gjatë procesit buxhetor vëmendje të shtuar duhet t'i japim zbatimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit si dhe respektimin e Udhëzimit Administrativ për Kriteret për Përzgjedhjen e Projekteve Kapitale

## **V.Korniza fiskale komunale**

Gjatë vitit 2019 kemi pasur një rritje të 4.0% të BPV-së, mirpo për shkak të përhapjes së pandemisë vlerësohet se BPV do të ketë rënie në -2.1%, kjo kjo trajektore për vitet 2022-2023 pritet të ngritët në 4.0%.

Bazuar në Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2021-2023 e cila i përcakton grantet për financimin e komunave për vitin 2021 dhe orientimet për vitet 2022-2023, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare. Po ashtu, ky dokument përcakton nivelin e të hyrave vetanake të komunave për vitin fiskal 2021 si dhe parashikimin afatmesëm 2022-2023.

Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2021, bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Tabelën 1 të projeksioneve makro-fiskale, të përgatitur nga Ministria e Financave dhe Transfereve siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP). Komisioni i Granteve ka aprovuar financimin komunal për vitin 2021 dhe projeksionet për vitin 2022-2023.

Ndonëse komuna nuk udhëheq drejtëpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në financat komunale dhe si i tillë do të trajtohet në vijim (shih tabelën më poshtë). Korniza afatmesme buxhetore e komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2021-2023 e përpiluar nga Qeveria e Kosovës. Komponentët e politikës makroekonomike janë: Bruto produkti vendor, inflacioni, demografia etj, të cilat duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2021-2023 e Qeverisë së Kosovës është bazuar në të dhënat historike, mirëpo situata e krijuar nga COVID 19 ka ndikuar që lakorja e të hyrave të përgjithshme të shënoj një rënie në formë të shkronjës “V”. Nga një ngritje prej 11.4% në vitin 2019 kanë pësuar rënie në prej 5.3%, pritet që në periudhën afatmesme të kemi një stabilizim të të hyrave në 8.3%, kryesisht bazuar në masat që do t'i ndërmerr Qeveria për rimëkëmjen e ekonomisë.

Me Kornizen Afatmesme të Shpenzimeve përcaktohen grantet qeveritare për financimin e komunave për vitin 2021 dhe parshikimet për vitet 2022-2023. Po ashtu me këtë dokument përcaktohet edhe niveli i të hyrave vetanake.

Parimet dhe kriteret për ndarjen e granteve qeveritare janë të përcaktuara me LFPL.

## Granti i Përgjithshëm

Bazuar në Tabelën 1, të paraqitur në vijim, të përgatitur nga Departamenti i Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar të Ministrisë së Financave në përputhje me LFPL, Granti i Përgjithshëm për komuna për vitin 2020 është aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 196.3 milion euro.

Përshkrimi	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
A. Të hyrat e përgjithshme të Qeverisë	1,896.00	1,920.3	2,060.5	2,006.8	2,125.8	2,255.3
Të hyrat e dedikuara	-50	-9.2				
Mbeshtetja buxhetore dhe grante	-5	-5	-10.5	-10.5	-10.5	-10.5
Tatimi në pronë	-30	-30	-33.2	-37.2	-40.1	-42.9
Të hyrat nga dividenda	-5					
Grantet e percaktuara të donatorëve	-12					
Taksa ngarkesa dhe të tjera nga Qeveria Lokale	-52	-57	-50	-50	-50	-50
Të hyrat e njëhershme nga borxhet	-6	-8				
Të hyrat nga interesi		-4.2	-4.0	-4.2	-4.2	-4.2
B. Baza për llogaritjen e grantit të përgjithshëm për komuna	1,736	1,806.9	1,962.8	1,904.9	2,021.0	2,147.7
C. Granti i përgjithshëm për komuna (10%)	173.60	180.69	196.28	190.49	202.1	214.77

Me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, bazuar në LFPL, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë. Pas kësaj, shpërndarja e bërë nëpër komuna bazohet në formulën për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna sipas LFPL: (i) numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); (ii) përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%); (iii) numri i popullsisë pakicë në komunë me tre përqind (3%); (iv) komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat me dy përqind (2%).

Sipas këtij kriteri Komunës së Vushtrrisë i takon sipas:

Shumë fikse prej 140,000 €, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori.-----	70,130.00 €
Numri i popullsisë (89%) -----	6,527,654.00 €
Shuma për madhësi gjeografike (6%) -----	354,964.00 €
Shuma për popullsi pakicë në komunë (3%) -----	49,862.00€
	<b>7,002,601.00€</b>

## Granti specifik për Arsim parauniversitar për vitin 2021

Granti Specifik për Arsim parauniversitar sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit parauniversitar të MASHTI për vitin 2021.

Grantin specifik për arsim parauniversitar për vitin 2021 është aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 194.8 milion euro.

Granti bazë është aprovuar në shumë prej 192 milion euro si vijon:

- Paga dhe shtesa në shumë prej 175.5 milion euro;

- b) Mallra dhe shërbime në shumë prej 14 milion euro;
- c) Shpenzime kapitale në shumë prej 2.5 milion euro.

Politikat e reja të aprovuara nga KG janë si vijon:

- a) Pagat jubilarë sipas kontratës kolektive për Arsim, me kosto prej 1.1 milion euro;
- b) Paga për parafillor për shkolla (2 deri në 5 vjeç) për vitin 2021, me kosto prej 1.6 milion euro;
- c) Mallra dhe Shërbime për fëmijë (4 deri në 5 vjeç), me kosto prej 78,848 euro;
- d) Kosto e pagesës së procedurave për validim dhe akreditim për shkollat e mesme të larta profesionale (8 Shkolla), me kosto prej 38,400 euro.

Formula trajton nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm, duke marrë për bazë këto kritere:

- a) Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2019/2020;
- b) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3 (bazuar në Udhëzimin administrativ nr.22/2013 të MASHT);
- c) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;
- d) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor 1:12;
- e) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë 1:17.2, dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;
- f) Raporti nxënës-mësimdhënës për zonat malore 1:14.2;
- g) Kalkulimi për stafin mësimdhënës të gjuhës angleze për klasën I dhe II;
- h) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 nxënës 1 staf në arsimin parafillor dhe fillor;
- i) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 nxënës 1 staf në arsimin e mesëm
- j) Kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës 1 staf (pastrues) si dhe 1 staf për shkollë (roje);
- k) Kalkulimi i pagave dhe shtesave është bazuar në mesataren e pagës aktuale në arsim për secilën komunë;
- l) Shërbimi profesional Pedagogjik/Psikologjik;
- m) Koordinatorët e cilësisë;
- n) Kalkulimi i pagave për zëvendësimet gjate pushimeve të lehonisë nga 3% në 6%;
- o) Mallrat dhe shërbimet janë kalkuluar sipas kriterit për nxënës (23 euro për nxënës shumicë dhe 25 euro për nxënës pakicë) dhe për shkollë (1,500 euro për shkollë parafillore dhe fillore dhe 3,250 euro për shkollë të mesme);
- p) Kapitalet janë kalkuluar sipas kriterit 7 euro për nxënës;
- q) Kalkulimi i tri pagave pas pensionimit me kosto prej 1.2 milion euro;
- r) Paga për asistent për fëmijë me nevoja të veçanta me kosto prej 0.6 milion euro;
- s) Praktika profesionale me kosto prej 3.5 milion euro;
- t) Pagat jubilarë sipas kontratës kolektive për Arsim, me kosto prej 1.1 milion euro;
- u) Paga për parafillor për shkolla (2 deri në 5 vjeç) për vitin 2021, me kosto prej 1.6 milion euro;
- v) Mallra dhe Shërbime për fëmijë (4 deri në 5 vjeç), me kosto prej 78,848 euro;
- w) Kosto e pagesës së procedurave për validim dhe akreditim për shkollat e mesme të larta profesionale (8 Shkolla), me kosto prej 38,400 euro.

Sipas MASHTI është raportuar numri për 10,338 nxënës më pak në arsim parauniversitar krahasuar me vitin paraprak. Duke u bazuar në zvogëlimin e vazhdueshëm të numrit të nxënësve nga viti në vit dhe duke marrë për bazë parametrat mësimdhënës/nxënës sipas gjendjes aktuale, MASHT rekomandon komunat se me rastin e pensionimit të stafit mësimdhënës mos të shpallin konkurs për pranimin e kuadrit të ri, por të sistemojnë mësimdhënësit të cilët nuk kanë normë ose nuk kanë normë të plotë.

Me Qarkoren Buxhetore 2021/01 janë ndarë mjete për 14,469 nxënës, duke përfshirë pagat me rastin e pensionimit, praktika profesionale, shpenzime kapitale, paga jubilarë me rastin e pensionimit, paga për arsimin parafillor si dhe mjete për politika të reja.

Granti për arsim parauniversitar për vitin 2021 është 7,661,677.00€, krahasuar me vitin 2020 kemi buxhet më pak për 509,756.00 €

### **Granti specifik për shëndetësi primare**

Granti specifik për Shëndetësi bazohet në sistem të hapur në përputhje me LFPL.

Grantin specifik për shëndetësi primare për vitin 2021 është aprovuar nga KG në shumë prej 62.6 milion euro.

Granti specifik për shëndetësi primare-granti bazë për vitin 2021 është në shumë prej 61.7 milion euro dhe është përgatitur sipas kriterit për kokë banori (35 €) dhe në pajtim me rekomandimet e Komisionit të Granteve të dala nga raporti vjetor mbi Vlerësimin e Përshtatshmërisë së Sistemit të Financimit Komunal.

Politika e re e aprovuar nga KG për vitin 2021 është vizitat e kujdesit paliativ (vizitë x 20 euro) me kosto prej 0.9 milion euro.

Shuma e ndarë për shërbime shëndesore për vitin 2021 është 2,425,419.00 €, krahasuar me vitin 2020 kemi buxhet më shumë për 80,144.00

### **Financimi për shërbimet rezidenciale për vitin 2021**

Financimi i shërbimeve rezidenciale për shtëpitë e komunitetit për personat e moshuar dhe shtëpitë e komunitetit për personat me aftësi të kufizuara për vitin 2021 është aprovuar sipas propozimit nga MSH në shumë prej 2,305,000 euro. Për Komunën e Vushtrrisë për financimin e shërbimeve rezidenciale janë të ndara 175,000 euro

## **Projeksionet e të Hyrave Vetanake Komunale për vitin 2021 dhe parashikimet 2022- 2023**

Projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2021 bazuar në vlerësimet makro-fiskale, janë në shumë prej 83.1 milion euro. Këto të hyra i shtohen financimit komunal krahas granteve komunale. Projekcioni i të hyrave vetanake për secilën komunë është bazuar në rekomandimet e komisionit të granteve, të përfshirë në raportin e “Vlerësimin të Përshtatshmërisë së Financimit të Komunave”.

Në këtë projektion janë marrë parasysh të hyrat nga tatimi në pronat e paluajtshme sipas faturimit të tatimit në pronë (ngarkesat tatimore) dhe trendin e rritjes së të hyrave jo tatimore gjatë tri viteve të fundit, duke përjashtuar të hyrat nga gjobot në trafik dhe të hyrat nga gjykatat. Në këto projeksione janë marrë parasysh trendet e realizimit të të hyrave jo tatimore gjatë tre viteve të fundit, të hyrat nga tatimi në pronat e paluajtshme sipas faturimit të tatimit në pronë, duke përjashtuar nga këto projeksione të hyrat nga gjobot në trafik dhe të hyrat nga gjykatat, pasi që këto gjopa planifikohen nga niveli qendror.

Projeksioni i të hyrave vetanake për vitin 2021 është bazuar në rekomandimet e komisionit të granteve, të përfshirë në raportin e “Vlerësimin të Përshtatshmërisë së Financimit të Komunave”.

Në këtë projeksion merret parasysh realizimi i të hyrave vetanake komunale për tri vitet e kaluara, duke përfshirë të hyrat e njëherëshme, duke vendosur një objektiv real të rritjes, me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë financiare të komunës. Gjithashtu në projeksionin e të hyrave vetanake kemi paraparë të hyra nga taksa komunale për mbeturina, për periudhën 2021-2023 .

Kalkulimet e tatimit në pronë:

- Vlera e patundshmërisë – sipas ndarjes së pronave në kategori të zonave;
- Vlera e kalkuluar vjetore - që duhet të mblidhet sipas vlerësimit të pronës (nëse supozojmë 100% pagesë sipas normave të përcaktuara me ligj);
- Norma e pagesës vjetore - pagesat për vit, duke përfshirë pagesat e borxhit, interesin dhe penaltitë si përqindje e vlerës vjetore të kalkuluar;
- Borxhi i akumuluar dhe pagesa e borxhit të pritur;
- Ndryshimet e pritura në normën e pagesës vjetore.

Bazuar në qarkoren buxhetore 2021/01 si edhe vitin e kaluar, kemi planifikuar vetëm 42,723.00€, shumë e cila gjatë viteve vijuese do të ketë ngritje.

Kalkulimet e të hyrave tjera:

- Të gjitha të hyrat tjera vetanake të komunave janë të hyra jotatimore (kryesisht taksa dhe pagesa tjera);
- Niveli i taksave dhe pagesave tjera vendoset nën principin e mbulueshmërisë së shpenzimeve të dedikuara për ofrimin e shërbimit komunal;
- Parashikimi i këtyre të hyrave duhet të bëhet duke parashikuar volumin e shërbimeve të ofruara.

Financimi komunal nga të hyrat vetanake komunale për vitin 2021, të parashikuara në KASH komunal 2021-2023, bazohet në dispozitat e ligjit për Financat e Pushtetit Lokal.

Të gjitha të hyrat nga burimet në vijim janë të hyra vetanake të komunës: Tatimi në pronë, taksat komunale, gjobat, tarifat dhe pagesat në pajtim me autoritetin që u është dhënë komunave me LFPL.

Të gjitha të hyrat e mbledhura ose të pranuar nga komuna në bazë të autorizimit të një ligji nga burimet në vijim, janë të hyra vetanake të komunës:

- a) taksat komunale, gjobat, tarifat e shfrytëzimit, pagesat e tjera për shërbimet publike të ofruara nga komuna, si dhe detyrimet rregullatore dhe gjobat e autorizuara në bazë të këtij ligji;
- b) qiratë në pronat e paluajtshme, të cilat ndodhen në komunë dhe të cilat janë nën administrimin ose në pronësi të komunës;
- c) të hyrat nga shitja e pasurive komunale;
- d) të hyrat nga ndërmarrjet, të cilat janë plotësisht ose pjesërisht në pronësi të komunës;
- e) bashkëpagesat nga konsumatorët e shërbimeve arsimore dhe shëndetësore, të cilat ofrohen nga komuna;
- f) të hyrat e realizuara nga cilado agjenci, departament ose organizatë e komunës, si rezultat i ofrimit të çfarëdo malli ose shërbimi;
- g) interesi në depozitat komunale, nëse ekziston;
- h) grantet dhe donacionet nga qeveritë e huaja (përveç ndihmës financiare nga Republika e Serbisë) ose nga organizatat e jashtme, duke përfshirë organizatat qeveritare dhe joqeveritare, si dhe institucionet ndërkombëtare dhe multinacionale;
- i) të gjitha kategoritë e tjera të të hyrave, të cilat janë përcaktuar si të hyra vetanake komunale në bazë të një ligji të Republikës së Kosovës.

Që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Mbeturinat (Ligji nr.04/L-060), sipas politikave të qeverisë, grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve, si dhe shërbimet tjera të pastrimit, i janë deleguar autoriteteve lokale përmes promovimit të decentralizimit. Pra ky ligj delegon më shumë autoritet dhe përgjegjësi te qeverisja lokale sa i përket menaxhimit të mbeturinave. Pra në këtë kuadër janë qartësuar edhe përgjegjësitë dhe detyrimet e komunës për zbatimin e dispozitave të këtij ligji. Drejtoria për Shërbime Publike, me qëllim të implementimit të kësaj infrastrukture ligjore, krijimit të një ambienti të pastër dhe të shëndoshë përmes menaxhimit të plotë të mbeturinave, ka hartuar Planin për Menaxhimin e Mbeturinave brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë

Prandaj bazuar në nevojën imediate për menaxhimin e mirëfilltë të mbetjeve, kërkojmë miratimin e këtyre mjeteve të planifikuara nga taksa për grumbullimin e mbeturinave e cila sipas disa përlllogaritjeve kapë shumën mbi 500,000 euro. Ky planifikim i të hyrave vetanake të komunës është në përputhje me Qarkoren buxhetore 2020/01 të lëshuar nga Ministria e Financave.



Tabela e planifikimi i të hyrave vetanake 2021 – 2023

	Komuna: Vushtri	THV - 2021	THV - 2022	THV - 2023
<b>1</b>	<b>Buxhet dhe Financa</b>	<b>943,124.00</b>	<b>1,002,644.00</b>	<b>1,062,163.00</b>
1.1.	Taksat e firmave	20,000.00	20,000.00	20,000.00
1.2.	Tatimi në pronë	735,000.00	756,895.00	771,265.00
1.3	Tatimi në toka	188,124.00	225,749.00	270,898.00
<b>2</b>	<b>Ispektimet</b>	<b>15,000.00</b>	<b>15,000.00</b>	<b>15,000.00</b>
2.1	Pranime teknike	6,000.00	6,000.00	6,000.00
2.2	Pëlqime sanitare	8,000.00	8,000.00	8,000.00
2.3	Gjjobat e inspektionit	1,000.00	1,000.00	1,000.00
<b>3</b>	<b>Administrata</b>	<b>70,000.00</b>	<b>80,000.00</b>	<b>80,000.00</b>
3.1.	Shërbimet administrative	70,000.00	80,000.00	80,000.00
<b>4</b>	<b>Urbanizmi</b>	<b>180,000.00</b>	<b>213,145.00</b>	<b>215,000.00</b>
4.1.	Lejet për ndërtim dhe konstruktive	140,000.00	163,145.00	165,000.00
4.2	Shfrytëzimi i pronës publike	40,000.00	50,000.00	50,000.00
<b>5</b>	<b>Gjeodezi dhe kadastër</b>	<b>59,000.00</b>	<b>73,000.00</b>	<b>75,000.00</b>
5.1.	Hipoteka, RDDP, dalje në terren	34,000.00	45,000.00	45,000.00
5.2.	Listat poseduese, kopje plani, vërtetime tjera	25,000.00	28,000.00	30,000.00
<b>6</b>	<b>Ekonomi dhe bujqësi</b>	<b>10,000.00</b>	<b>20,000.00</b>	<b>10,000.00</b>
6.1	Ndërrimi i tokës bujqësore në ndërtimore	10,000.00	20,000.00	10,000.00
<b>7</b>	<b>Kulturë, rini, sport</b>	<b>2,500.00</b>	<b>2,000.00</b>	<b>2,000.00</b>
7.1.	Palestra sportive	1,000.00	1,000.00	1,000.00
7.2.	Bibliotekat	500.00	500.00	500.00
7.3.	Shtëpia e kulturës	1,000.00	500.00	500.00
<b>8</b>	<b>Shërbimet publike</b>	<b>630,036.00</b>	<b>758,000.00</b>	<b>764,146.00</b>
8.1	Ndalja e veturave në rrugë	3,000.00	3,000.00	4,000.00
8.2	Taksat rrugore	80,000.00	90,000.00	91,052.00
8.3	Taksa për mbeturina	547,036.00	665,000.00	669,094.00
<b>I</b>	<b>Totali i Administratës komunale</b>	<b>1,909,660.00</b>	<b>2,163,789.00</b>	<b>2,223,309.00</b>
	<b>ARSIMI</b>			
1	Çerdhet	45,000.00	50,000.00	50,000.00
2	Mësimi joformal SHMP "Bahri Haxha"	15,000.00	14,000.00	14,000.00
3	Mësimi joformal SHMT "Lutfi Musiqi"	14,000.00	13,000.00	13,000.00
<b>II</b>	<b>Totali - Arsimi</b>	<b>74,000.00</b>	<b>77,000.00</b>	<b>77,000.00</b>
	<b>TË ARDHURAT NGA SHËNDETËSIA</b>			
1	Shëndetësia primare	50,000.00	50,000.00	50,000.00
2	Shërbimet sociale	2,000.00	2,000.00	2,000.00
<b>III</b>	<b>TOTALI SHËNDETËSI</b>	<b>52,000.00</b>	<b>52,000.00</b>	<b>52,000.00</b>
Kodi 21	<b>TOTALI I TË ARDHURAVE VETANAKE TË KOMUNËS ( I+II+III )</b>	<b>2,035,660.00</b>	<b>2,292,789.00</b>	<b>2,352,309.00</b>

## **Huamarrja**

Komuna e Vushtrrisë në periudhën afatmesme buxhetore 2021-2023 planifikon të marrë hua nga institucione financiare, për të financuar projektin për trajtimin e ujrave të zeza.

Qyteti i Vushtrrisë dhe një numër i vogël i fshatrave kanë trashëguar nga paraluftra rrjet të kanalizimit, edhe këto kanalizime nuk kanë qenë të ndërtuara sipas standardeve të kërkuara. Që nga pas lufta Komuna e Vushtrrisë vazhdimisht ka investuar në ndërtimin e rrjetit të kanalizimit. Është investuar në ndërtimin e rrjetit të kanalizimit në pjesën përfundimtare (Duboc, Galicë, Beqic, Bruznik, Kollë , Navolan, Reznik, Vërrnicë pjesërisht, Druar, Mihaliq pjesërisht, Gllavotin, Stroc pjesërisht, Bivolak dhe Zhilivodë) të gjitha këto rrjedha shkarkohen në afërsi të lumit Silnica, kurse në pjesën lindore është investuar në fshatrat:Smrekonicë, Dobërllukë, Bajskë pjesërisht, Begaj, Gojbulë, Sfaraqak, Nadakoc, Pestovë, Maxhunaj, Samadrexhë, Dumnicë e Ulët , Dumnicë e Mesme Stanoc i Epërm pjesërisht, Lum Madh, Stanoc i ulët dhe Gracë dhe Prilluzhë, gjithashtu edhe në qytet. Mirëpo për përfundimin e rrjetit të kanalizimeve me qëllim të trajtimit të ujrave të zeza, piksëpari duhet edhe më tutje të ndërtohen vija të reja të kanalizimeve dhe rekonstruimi i rrjetit ekzistues. Ramja përgjatë lumit Silnica krijon parakushtin ideal për shtrirjen e kolektorit deri te fushat e Dobërllukës ku do të ndërtohet impianti për trajtimin e ujrave të zeza, të cilat pasandej si ujra të pastra do të derdhen në lumin Silnica.

Investimi në trajtimin e ujrave të zeza konsiderohen mjaft të rëndësishme për mjedisin pasi që do t'i japim zgjedhje përfundimtare ndotjes së lumenjëve dhe potencialisht prodhimit të biogazit.

Ndërtimi dhe rekonstruimi i rrjetit të kanalizimeve, ndërtimi i kolektorit dhe ndërtimi i fabrikës për trajtim të ujrave të zeza (impiantit), kërkon shuma të konsiderueshme për të cila shuma Komuna e Vushtrrisë planifikon huamarrjen për financimin e projektit të saj, siç e lejon Ligji mbi Financat Publike dhe Përgjegjësitë si dhe Ligji mbi Borgjin Publik.

## Indikatorët ekonomik

Për periudhën 2021- 2023, bazuar në të dhënat e publikuara për të gjithë indikatorët e ekonomisë së Kosovës dhe në zhvillimet aktuale apo të pritura në ekonominë e jashtme të publikuara deri më tani nga organizatat ndërkombëtare, parashikimet e Ministrisë së Financave rezultojnë të jenë gjegjësisht në linjë me ato të publikuara në Programin për Reforma në Ekonomi 2021-2023, me disa ndryshime të lehta në strukturën e rritjes së parashikuar ekonomike apo në dinamikën e rritjes ndër vite.


Për periudhën 2021-2023, rritja reale ekonomike mesatarisht vlerësohet të jetë 4.6%, duke filluar nga vlerësimi prej 4.7% në vitin 2019 dhe 2020, 4.5% në 2021 dhe 4.6% në 2022. Në periudhën afatmesme (2020- 2022), rritja ekonomike do të jetë e udhëhequr kryesisht nga konsumi privat dhe investimet totale, ndërkohë që kontributi i eksporteve pritet të rritet. Gjatë vitit 2020, rritja ekonomike në terma realë është më e lartë se projeksionet për dy vitet e ardhshme dhe më e lartë se projeksionet e fundit të publikuara në Programin për Reforma Ekonomike 2019- 2021, ndërsa në terma nominalë rritja ekonomike për vitin 2020 vazhdon të luhahet pothuajse rreth të njëjtit nivel (5.6%). Rritja më e madhe në vitin 2020 (krahasuar me projeksionet e mëparshme) vjen si rezultat i rritjes së konsumit publik që i atribuohet kryesisht rritjes së kategorisë “mallra dhe shërbime” dhe “subvencione dhe transfere” dhe si rezultat i një dinamike më të përshpejtuar të realizimit të investimeve publike gjatë vitit 2020. Gjithashtu, një nivel më i ulët i deflatorit të BPV-së në vitin 2020 krahasuar me raundin e kaluar të projeksioneve ka kontribuar në një rritje reale ekonomike me të lartë në këtë vit.

Përshkrimi	2020	2021	2022	2023 (vlerësim)
<b>Indikatorët makroekonomik në Kosovë</b>				
Rritja reale e BPV në %	-2.1	5.4	4.1	4.0
Inflacioni në %	0.9	2.1	1.8	1.8
BPV për kokë banori, në euro	3,951	4,247	4,496	4,755
<b>Indikatorët ekonomik komunal</b>				
Popullsia e komunës	74,115	74,352	74,589	74,752
Numri i bizneseve të regjistruara	4,097	4,267	4,337	4,529
Numri i nxënësve	14,699	14,833	14,900	15.060

## VI. Të hyrat komunale dhe parashikimi afatmesëm 2021-2023

Të hyrat e Komunës së Vushtrrisë nga dy burimet e saj kryesore – grantet qeveritare, si dhe të hyrat vetanake komunale.

Buxheti total i komunës në vite, milion euro:



Siç shihet në grafikon buxheti i ndarë për Komunën e Vushtrriasë për vitin 2021 ka shënuar rënie dhe atë në vlerë prej 639,619.00€. Granti i përgjithshëm nga 196.28 milion sa ishte për vitin 2020 në nivel vendi ka rënë në 190.49 milion, rënien më të madhe e kemi pasur në grantin e arsimit, kemi më pak mjete për 509,765.00€ kjo si pasojë i zvogëlimit të numrit të nxënësve.

Projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2021 bazuar në vlerësimet makro-fiskale, janë në shumë prej 83.1 milion euro. Këto të hyra i shtohen financimit komunal krahas granteve komunale. Projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 janë në nivelin e njëjtë.

(shih më poshtë tabelën 2)

	2020	2021	2022	2023
<b>Grantet qeveritare</b>	<b>17,904,306</b>	<b>17,264,678</b>	<b>19,221,058</b>	<b>19,760,524</b>
<b>Të hyrat vetanake</b>	<b>2,035,660</b>	<b>2,035,660</b>	<b>2,292,789</b>	<b>2,352,309</b>
<b>TOTALI</b>	<b>19,939,966</b>	<b>19,300,347</b>	<b>21,513,847</b>	<b>22,112,833</b>

	Komuna Vushtrri	Grante dhe të hyra vetanake (HV) – 2020	Grante dhe të hyra vetanake – 2021	Grante dhe të hyra vetanake – 2022	Grante dhe të hyra vetanake - 2023
		në euro	në euro	në euro	në euro
<b>Burimet e të hyrave</b>					
	Granti i përgjithshëm	7,217,599	7,002,601	7,433,345	7,903,416
	Granti për arsim	8,171,432	7,661,667	8,346,042	8,399,104
	Granti për shëndetësi	2,345,275	2,425,419	3,266,671	3,283,004
	Shërbimet rezidenciale	170,000	175,000	175,000	175,000
	<b>Gjithsej grantet</b>	<b>17,904,306</b>	<b>17,264,678</b>	<b>19,221,058</b>	<b>19,760,524</b>
	<b>Të hyrat e bartura</b>	<b>1,320,272</b>			
	<b>Të hyrat e vitit aktual</b>	<b>2,035,660</b>	<b>2,035,660</b>	<b>2,292,789</b>	<b>2,352,309</b>
	<b>Gjithsej të hyrat vetanake</b>	<b>21,260,238</b>	<b>19,300,347</b>	<b>21,513,847</b>	<b>22,112,833</b>
	<b>GJITHSEJ TË HYRAT KOMUNALE</b>	<b>20,154,883.35</b>	<b>19,939,966</b>	<b>20,393,936</b>	<b>21,077,392</b>

#### **VII.Plani komunal i bashkëfinancimit sektorial me ministritë e linjës dhe donatorët**

Komuna e Vushtrrisë, me qëllim të financimit të projekteve me donatorë potencial, në buxhetin e saj ndanë shuma në fondin për bashkfinacim me donatorë. Vlen të ceket se donator gati të përhershëm, të cilët financojnë projekte janë USAID-in me të cilin jemi në projektin për Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse dhe GIZ-in me të cilin jemi në partneritet në kuadër të reformës në fushën e menaxhimit të mbeturinave . Po ashtu në kuadër të sistemit të menaxhimit të performances në ofrimin e shërbimeve komunale kemi ndërtuar partneritet me DEMOS-in, nga i cili projekt në bazë të vlerësimit që është bërë tani, për vitin 2019 kemi përfituar shumën 185,515.00€

Vlera totale e projekteve me bashëfinancim me ministritë e linjës gjatë viteve 2019-2021 është 8,892,313euro.

Kodi	Përshkrimi	2020	2021	2022	TOTAL
<b>204</b>	<b>MISTRIA E TRGTISË DHE INDUSTRIË</b>				
15816	Ndërtimi parkut te biznesit ne zonen ekonomike te Vushtrisë	400 000			400 000
<b>205</b>	<b>MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS</b>				
18284	Ndërtimi I rrugës Skenderaj Vushtrri (fshati Krasmirovc)	200,000	307,378		507,378
18740	Zgjerimi i rrjetit te ujesjellesit - Vushtrri	750,000			750,000
18744	Rregullimi i shtratit te lumit Sitnica-Vushtrri	500,000	500,000	500,000	1,500,000
14975	Ndërtimi i rrugës magjistrale Nedakovc-Smrekovicë-Vushtrri	800,000	461,509		1,261,509
18192	Rehabilitim I Rruges Pantine - Oshlan	300,000	403,089		703,089
18440	Ndërtimi i rrethrotullimit ne rrugen magjistrale Prishtine-Mitrovice(M2) ne fshatin Pestove	50,000	100,000		150,000
14730	Riasfaltimi i rruges Rajonale R220, segmenti Bukosh-Polluzhe	514,505			514,505
<b>207</b>	<b>MINISTRIA E KULTURËS</b>				
14224	Ndërtimi i Palestres Sportive ne Samadrexhe te Vushtrise	200,000			200,000
15380	Qendra e Kulturës Hasan Prishtina - Vushtrri	200,000			200,000
18758	Stadiumi "Ferki Aliu", Vushtrri		190,000	200,000	390,000
15675	Ura e Gurit ne Vushtrri		10,000	10,000	20,000
15110	Konservimi dhe restaurimi i Shtepisë së Shaban Agës në Vushtrri	40,000	40,000	20,000	100,000
<b>208</b>	<b>MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË</b>				
18018	Ndërtimi I sallës së sportit në Vushtrri	50,000	100,000	200,000	350,000
18043	Renovimi I shkolles fillore ne Smerkovnice - Vushtrri			150,000	150,000
<b>253</b>	<b>AGJNCIA PËR MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE</b>				
18277	Memoriali i Martirëve "Studime" Vushtrri	40,000			50,000
18662	Shtatorja e Xhavit Hazirit Vushtrri	60,000			60,000

### Shpenzimet komunale sipas kategorive ekonomike për vitin 2020-2022

Shpenzimet buxhetore në periudhën afatmesme priten të stabilizohen pas pandemisë COVID 19 dhe gradualisht të rikthehen në nivelet e rritjes historike. Viti 2021 karakterizohet nga një rënie në disa

prej kategorive të shpenzimeve kryesisht për shkak të efektit bazë të vitit 2020, kur ka patur një rritje të theksuar në disa kategori si rrjedhojë e masave stimuluese fiskale të qeverisë. Gjithashtu, shpenzimet janë planifikuar në atë mënyrë që të jenë në respektim të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike.


**Pagat dhe mëditjet** - kategoria e shpenzimeve për paga dhe mëditje planifikohet të rritet pas implementimit të Ligjit për Paga, mirëpo duke respektuar LMFPP që rritja të bëhet konform rritjes ekonomike nominale. Rritja në këtë kategori të shpenzimeve është planifikuar të mbajë një mesatare prej rreth 5.6% përgjatë periudhës së ardhshme afat-mesme, përderisa pjesëmarrja e përgjithshme e kësaj kategorie në BPV parashikohet të jetë mesatarisht rreth 8.7%, duke ruajtur trendin e njëjtë të pjesëmarrjes si në vitet paraprake, projeksioni i shpenzimeve në kategorinë e pagave dhe shtesave për vitin 2021 mund të pësojë ndryshim si rrjedhojë e vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese lidhur me Ligjin e Pagave në Sektorin Publik.

**Mallra dhe shërbime** – Me qëllim të racionalizimit të shpenzimeve për mallra dhe shërbime, si dhe përfshirjes së iniciativave të reja të cilat në vete bartin kosto shtesë, kategoria e mallrave dhe shërbimeve pritet të rritet me një mesatare prej 2.2% në periudhën afatmesme. Mirëpo gjatë vitit 2021 do të kemi një rënie të lehtë për shkak të kufizimit të shpenzimeve lidhur me deficitin buxhetor. Rritja më e lartë parashihet në vitin 2022, si rrjedhojë e ri klasifikimit prej shpenzimeve kapitale në këtë kategori. Përkundër këtyre ndryshimeve, shpenzimet për mallra dhe shërbime pritet të jenë mesatarisht 4.5% në raport me BPV, raport i cili është i ngjashëm me vitet paraprake.

**Subvencionet** – Në vitin 2021, Komuna Vushtrisë planifikon shumën 500,000 € në kategorinë e subvencioneve, subvencionet do të ofrohen në bujqësi, shëndetësi, organizatat e ndryshme, klubet sportive, kulturë, rini, sport, arsim (bursat) etj. Pjesëmarrja e subvencioneve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore gjatë viteve 2021-2023 mesatarisht do të jetë 3 %.

**Investimet kapitale** - përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve të përgjithshme. përfaqësojnë rreth 25%. Kjo kategori e shpenzimeve pritet të shënojë rënie rreth 20%, në krahasim me vitin 2020. Një pjesë e madhe e tyre planifikohet të financohet nga të hyrat vetanake të Komunës. Edhe në këtë kategori rënia është për shkak të kufizimeve buxhetore që lidhen me deficitin buxhetor.

Tabelat në vijim janë një pasqyrë e shpërndarjes së shpenzimeve komunale në bazë të programeve apo dhe në bazë të kategorive ekonomike. Shpenzimet në vijim janë si ato aktualet të vitit 2018, planifikimi për vitin e ardhshëm 2020 si dhe projeksionet e vitit 2021-2022.





Shpenzimet komunale 2020 (këtë vit), të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe

	Nr. I Punetoreve	2020					Gjithsej
		Paga/Mëditje	Mallra/Shërbime	Shpenzime komunali	Subvencione	Shpenzime kapitale	
Zyra e Kryetarit	24	203,913.0	78,100.0		52,914.0		334,927
Zyra e Kuvendit komunal		143,146.0	25,000.0				168,146
Administrata dhe personeli	30	192,193.0	203,897.0			45,000.0	441,090
Inspektimet	14	99,322.0	36,900.0				136,222
Prokurimi	5	40,192.0	5,550.0				45,742
Buxhet dhe financa	27	180,591.0	32,126.0				212,717
Infrastrukturë publike	13	85,256.0	975,000.0	153,907.0		1,569,561.0	2,783,724
Zjarrfikësit dhe inspektimet	31	219,971.0	62,600.0				282,571
Menaxhimi i katastrofave	4	31,570.0	55,600.0				87,170
Zyra komunale për komunitete	9	47,045.0	800.0	6,000.0			53,845
Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural	15	101,294.0	68,000.0			560,000.0	729,294
Kadastri dhe gjeodezia	14	96,079.0	18,500.0			110,000.0	224,579
Planifikimi urban dhe mjedisi	10	72,526.0	45,200.0			1,026,358.0	1,144,084
<b>Shëndetësi</b>	<b>210</b>	<b>1,727,690</b>	<b>356,665</b>	<b>43,200</b>	<b>100,000</b>	<b>302,025</b>	<b>2,529,580</b>
Administrata	5	36,654	2,626		100,000		139,280
Shërbimet e shëndetësisë primare	205	1,691,036	354,039	43,200		302,025	2,390,300
Shërbimet sociale dhe rezidenciale	24	<b>164,123</b>	<b>107,000</b>	<b>11,600</b>	-	<b>15,000</b>	<b>297,723</b>
Shërbimet sociale	13	79,123	35,000	3,600		5,000	122,723
Shërbimet rezidenciale	11	85,000	72,000	8,000		10,000	175,000
Kulturë, rini dhe sport	36	215,783	59,600		90,000	305,000	670,383
Arsim dhe shkencë	1,121	7,779,434	1,080,958	94,328	50,000	793,447	9,798,167
Administrata	12	95,023	592,996		50,000	333,714	1,071,733
Arsimi parashkollor	29	180,164	51,000	7,000		97,000	335,164
Arsimi fillor	854	5,656,099	252,307	59,966		329,733	6,298,105
Arsimi i mesëm	226	1,848,148	184,655	27,362		33,000	2,093,165
<b>GJITHSEJ</b>	<b>1,587</b>	<b>11,400,128</b>	<b>3,211,496</b>	<b>309,035</b>	<b>292,914</b>	<b>4,726,391</b>	<b>19,939,964</b>

**Projeksioni i shpenzimeve për vitin 2021, të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe**

	2021					
	Paga/Mëditje	Mallra/Shërbime	Shpenzime komunal	Subvencione	Shpenzime kapitale	Gjithsej
Zyra e Kryetarit	210,030	77,319		60,000		297,349
Zyra e Kuvendit komunal	147,440	24,750				172,190
Administrata dhe personeli	197,959	201,858			20,000	419,817
Inspektimet	102,302	36,531				138,833
Prokurimi	41,398	5,495				46,892
Buxhet dhe financa	186,009	31,805				217,813
Infrastrukturë publike	87,814	965,250	153,907		1,125,437	2,332,408
Zjarrfikësit dhe inspektimet	226,570	61,974				288,544
Menaxhimi i katastrofave	32,517	55,044				87,561
Zyra komunale për komunitete	48,456	792	4,000			53,248
Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural	104,333	67,320		400,000	160,000	781,653
Kadastrri dhe gjeodezia	98,961	18,315			150,000	267,276
Planifikimi urban dhe mjedisi	74,702	44,748			897,546	1,016,996
<b>Shëndetësi</b>	<b>1,948,567</b>	<b>459,028</b>	<b>56,800</b>	<b>100,000</b>	<b>312,953</b>	<b>2,877,349</b>
Administrata	37,754	2,600		50,000		90,353
Shërbimet e shëndetësisë primare	1,741,767	350,499	43,200	50,000	289,953	2,475,419
Shërbimet sociale	81,497	34,650	3,600		3,000	122,747
Shërbimet rezidenciale	87,550	71,280	10,000		20,000	188,830
Kulturë, rini dhe sport	222,256	59,004		100,000	195,007	576,267
<b>Arsim dhe shkencë</b>	<b>8,012,817</b>	<b>1,070,148</b>	<b>94,328</b>	<b>35,000</b>	<b>513,856</b>	<b>9,726,149</b>
Administrata	97,874	587,066		35,000	190,000	909,940
Arsimi parashkollor	185,569	50,490	7,000		50,000	293,059
Arsimi fillor	5,825,782	249,784	59,966		158,250	6,293,782
Arsimi i mesëm	1,903,592	182,808	27,362		115,606	2,229,369
<b>GJITHSEJ</b>	<b>11,742,132</b>	<b>3,179,381</b>	<b>309,035</b>	<b>695,000</b>	<b>3,374,799</b>	<b>19,300,347</b>

**Projeksioni i shpenzimeve për vitin 2022, të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe**

	2022					
	Paga/Mëditje	Mallra/Shërbime	Shpenzime komunal	Subvencione	Shpenzime kapitale	Gjithsej
Zyra e Kryetarit	220,532	66,999		10,000		297,531
Zyra e Kuvendit komunal	154,812	9,448				164,261
Administrata dhe personeli	207,857	192,324			20,000	420,180
Inspektimet	107,417	20,872				128,289
Prokurimi	43,468	6,495				49,963
Buxhet dhe financa	195,309	25,038				220,347
Infrastrukturë publike	92,204	1,094,444	161,602		1,475,437	2,823,687
Zjarrfikësit dhe inspektimet	237,899	60,857				298,755
Menaxhimi i katastrofave	34,143	38,695				72,838
Zyra komunale për komunitete	50,879	6,705	4,200			61,784
Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural	109,549	22,032		450,000	160,000	741,581
Kadastrri dhe gjeodezia	103,909	8,116			150,000	262,026
Planifikimi urban dhe mjedisi	78,437	37,912			1,322,215	1,438,564
<b>Shëndetësi</b>	<b>2,045,996</b>	<b>514,494</b>	<b>59,640</b>	<b>100,000</b>	<b>308,000</b>	<b>3,028,130</b>
Administrata	39,641	2,817		50,000		92,458
Shërbimet e shëndetësisë primare	1,828,855	398,960	45,360	50,000	285,000	2,608,176
Shërbimet sociale	85,572	32,189	3,780		3,000	124,540
Shërbimet rezidenciale	91,928	80,528	10,500		20,000	202,956
Kulturë, rini dhe sport	233,369	40,586		100,000	425,007	798,962
<b>Arsim dhe shkencë</b>	<b>8,413,458</b>	<b>1,385,589</b>	<b>99,044</b>	<b>35,000</b>	<b>773,856</b>	<b>10,706,947</b>
Administrata	102,767	724,431		35,000	280,000	1,142,198
Arsimi parashkollor	194,847	46,384	7,350		50,000	298,581
Arsimi fillor	6,117,071	327,026	62,964		328,250	6,835,311
Arsimi i mesëm	1,998,772	287,748	28,730		115,606	2,430,856
<b>GJITHSEJ</b>	<b>12,329,238</b>	<b>3,530,607</b>	<b>324,486</b>	<b>695,000</b>	<b>4,634,515</b>	<b>21,513,847</b>

**Projeksioni i shpenzimeve për vitin 2023, të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe**

	2023					
	Paga/Mëditje	Mallra/Shërbime	Shpenzime komunal	Subvencione	Shpenzime kapitale	Gjithsej
Zyra e Kryetarit	229,353	67,669		70,000		367,023
Zyra e Kuvendit komunal	161,005	9,543				170,548
Administrata dhe personeli	216,171	194,247			20,000	430,418
Inspektimet	111,713	21,081				132,794
Prokurimi	45,206	6,560				51,766
Buxhet dhe financa	203,122	25,289				228,410
Infrastrukturë publike	95,893	1,105,388	161,602		1,435,948	2,798,831
Zjarrfikësit dhe inspektimet	247,415	61,465				308,880
Menaxhimi i katastrofave	35,509	39,082				74,591
Zyra komunale për komunitete	52,914	6,772	4,200			63,887
Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural	113,931	22,252		500,000	160,000	796,183
Kadastrri dhe gjeodezia	108,066	8,198			150,000	266,263
Planifikimi urban dhe mjedisi	81,574	38,291			1,322,215	1,442,081
<b>Shëndetësi</b>	<b>2,127,836</b>	<b>519,639</b>	<b>59,640</b>	<b>100,000</b>	<b>308,000</b>	<b>3,115,115</b>
Administrata	41,227	2,845		50,000		94,072
Shërbimet e shëndetësisë primare	1,902,010	402,950	45,360	50,000	285,000	2,685,319
Shërbimet sociale	88,994	32,510	3,780		3,000	128,285
Shërbimet rezidenciale	95,605	81,334	10,500		20,000	207,438
Kulturë, rini dhe sport	242,704	40,992		100,000	425,007	808,703
<b>Arsim dhe shkencë</b>	<b>8,749,996</b>	<b>1,399,445</b>	<b>99,044</b>	<b>35,000</b>	<b>773,856</b>	<b>11,057,341</b>
Administrata	106,878	731,675		35,000	280,000	1,153,553
Arsimi parashkollor	202,641	46,848	7,350		50,000	306,839
Arsimi fillor	6,361,754	330,296	62,964		328,250	7,083,264
Arsimi i mesëm	2,078,723	290,625	28,730		115,606	2,513,684
<b>GJITHSEJ</b>	<b>12,822,408</b>	<b>3,565,913</b>	<b>324,486</b>	<b>805,000</b>	<b>4,595,026</b>	<b>22,112,833</b>

## INVESTIMET KAPITALE

Kategoria ekonomike investimet kapitale e prezantuar në detaje më poshtë paraqet një komponentë të rëndësishme të buxhetit të komunës e cila ndonëse nuk përfaqëson pjesën më të madhe të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, mbetet me rëndësi të posaçme në aspektin e planifikimit për Komunën e Vushtrrisë. Kjo kategori e shpenzimeve në kuadër të shpenzimeve të rregullta buxhetore, ka potencialin më të madh për të nxitur rritjen ekonomike. Andaj, kjo kategori e shpenzimeve edhe gjatë periudhës së ardhshme afatmesme do të vazhdojë të jetë në funksion të krijimit të ambientit më të favorshëm për ngritje të pjesëmarrjes të sektorit privat, përmes përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës. Përderisa ndikimi i këtyre investimeve në punësim dhe konsum është relativisht i shpejtë, ndikimi i plotë i tyre në ekonomi do të mund të realizohet vetëm në periudhën afatmesme. Në këtë kontekst përmirësimi i infrastrukturës do të pozicionojë ekonominë e Komunës së Vushtrrisë në një rrugë të rritjes më të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike në periudhën afatgjatë.

Projektet kapitale të komunës 2020-2022 dhe kostoja e asociuar me total në euro

<b>Projektet e propuzuara</b>					
<b>Nr</b>	<b>Drejtoria e Administratës</b>	<b>Shuma € 2020 (vitin e 1)</b>	<b>Shuma € 2021 (vitin e 2)</b>	<b>Shuma € 2022 (vitin e 3)</b>	<b>Prioritetet strategjike</b>
	Sistemi modular I arkivit për objektin e ri të komunës	50.000			<b>Administratë funktionale</b>
	Sistemi elektronik I dyerve të Komunës	10,000			
	Teknologji informative	20.000	10,000	10,000	
	<b>TOTALI</b>	<b>80,000</b>	<b>10,000</b>	<b>10,000</b>	

<b>Drejtoria e Shërbimeve Publike</b>	<b>Shuma € 2020 (vitin e 1)</b>	<b>Shuma € 2021 (vitin e 2)</b>	<b>Shuma € 2022 (vitin e 3)</b>	
Sinjalizimi horizontal dhe vertikal	60,000	60,000	60,000	<b>Prioritetet strategjike</b>  -Urbanizimi i qendrës; -ndalimi i ndërtimeve të egra; -përmirësimi i infrastrukturës fizike; -mbrojtja e mjedisit; -identifikimi i burimeve të reja për financime të projekteve në infrastrukturë; -zvogëlimi i humbjeve të energjisë; -zhvillimi i projekteve për energji të ripërtërishme
Rrugët e rendit të katërt	60,000	60,000	60,000	
Furnizimi me gypa të ujërave të zeza	40,000	30,000	30,000	
Ndërtimi i kanalizimeve	200,000	205,437	205,437	
Projektet në bashkëfinancim me donatorë	80,000	100,000	100,000	
Ndriçimi publik	30,000	30,000	30,000	
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellsit	300,000	300,000	300,000	
Ndërtimi i parqeve	60,000	95,000	95,000	
Rekonstruimi i rrugëve të asfaltuara	130,000	180,000	180,000	
Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni	165,000	200,000	200,000	
Ndërtimi i urave	75,120	70,000	70,000	
Ndërtimi i rrethojave për varreza dhe rregullimi I përmendoreve	20,000	50,000	50,000	
Blerja e kontenjerëve për mbeturina	20,000	20,000	20,000	
Kamerat në qytet	20,000	25,000	25,000	
Ndërtimi i trotuareve	70,000	50,000	50,000	
<b>TOTALI</b>	<b>1,330,120</b>	<b>1,475,437</b>	<b>1,475,437</b>	

<b>Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural</b>					
<b>Programi/projekti</b>	<b>Shuma € 2020 (vitin e 1)</b>	<b>Shuma € 2021 (vitin e 2)</b>	<b>Shuma € 2022 (vitin e 3)</b>	<b>Prioritetet strategjike</b>	
<b>Ngritja e serrave</b>	45,000			-Përmirësimi i klimës së biznesit për një ambient më të favorshëm ndërmarrës; -ruajtja e ambientit (mjedisit) gjatë aktiviteteve ekonomike; -rritja dhe promovimi i investimeve përmes PPP, FDI dhe investimeve lokale; -punësimi i personave pa shkollim universitar, riaftësimi i personave që janë të papunë për periudha të gjata për ruajtjen e identitetit ekonomik të komunës; -ndërlidhja më e mirë në mes institucioneve arsimore-hulumtuese dhe industrisë; -rritja e numrit të të vetpunësuarve dhe atyre me vetiniciativë për krijimin e vendeve të reja të punës; -avancimi i agroindustrisë, zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë, pylltarisë e blegtorisë,	
Pajisje për kositje (kosë)	30,000				
<b>Makina për lëvrimin e kopshteve (motokultivator)</b>	30,000				
<b>Makina për mbjellje të misrit</b>	20.000				
<b>Makina për mbjellje të grurit</b>	20.000				
<b>Rregullimi i lumenjve dhe argjinaturave</b>	40.000				
<b>Pastrimi i lumit “Silnica”</b>	20,000				
<b>Fondi për bashkëfinancim</b>	60.000				
<b>Projekte, varësisht nga kërkesat e fermerëve</b>	200,000	400.000	500.000		
<b>TOTALI</b>	<b>450,000</b>	<b>500.000</b>	<b>600.000</b>		

<b>Gjeodezi, Kadastrë dhe Pronë</b>				
Projekti				Prioritetet strategjike
Shpronësimet	150,000			-Ofrimi i Shërbimeve sa më cilëore për qytetaret, -Incizimi i rrjeteve nentoksore të ujësjellësit, ujrave të zeza dhe kabllave elektrike, në mënyrë që të lehtësohet puna në projektet e ardhshme, - Eliminimi i diskrepancave në pronat që janë nën masën e komasacionit.
Renovimi i Objektivit të Kadastrit	40.000			
Rrjeta Gjeodezike	25.000			
Komasacioni	40.000			
Përcojat nëntoksore	100.000	100.000		
<b>TOTALI</b>	<b>355,000</b>			

<b>Planifikimi urban dhe mjedisi</b>				
Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatra	600,000	550,000	550,000	Mbështetja në zhvillimin e qëndrueshëm ka për qëllim përmirësimin e cilësisë të jetës së qytetarëve të komunës, dhe brezave që do të vijnë. -Mbrotjtja e mjedisit; -Urbanizimi i qytetit; -Konzervimi i zonës historike të qytetit
Ndërtimi i rrugëve në qytet	400,000	400,000	400,000	
Hartimi i projekteve	150,000	141,819	141,819	
Harta Zonale	25,158			
Mbjellja e drunjëve dekorativ	150,000	150,000	150,000	
Regullimi i hapsirave publike	170,000	170,000	170,000	
<b>TOTALI</b>	<b>1,495,158</b>	<b>1,411,819</b>	<b>1,411,819</b>	



Drejtoria				
Projekti	Shuma € 2021 (vitin e I)	Shuma € 2022 (vitin e II)	Shuma € 2023 (vitin e III)	Lidhja e projektit prioritetet strateg
Meremetimi I shkollave shkollave	100,000.00	100,000.00	100,000.00	Sektori i arsimit s zhvillim të shoqërisë,bazuar dije dhe shkathtë konkurrese e cil e integruar në rrj ndërkombëtare,r mundësi të barak për avancimin e s individ që të jetë gatshëm të kontr në zhvillimin e qëndrueshëm so ekonomik të veni
Ndërtimi I aneksit në shf" A.Z.Çajupi"	100,000.00	150,000.00	100,000.00	
Fusha sportive	45,000.00	45,000.00	45,000.00	
Ndërtimi I rrethojave në shkolla	70,000.00	60,000.00	50,000.00	
Depo nëpër shkolla	40,000.00	40,000.00	40,000.00	
Pajisje për mësim praktik për shkolla profesionale	100,000.00	100,000.00	100,000.00	
Ndërtimi I toaleteve	120,000.00	120,000.00	100,000.00	
Teknologji informative	50,000.00	50,000.00	50,000.00	
Inventar për shkolla	50,000.00	50,000.00	30,000.00	
Pajisje laboratorike dhe mjete konkretizimi	30,000.00	25,000.00	25,000.00	
Salla spotive	100,000.00	100,000.00	100,000.00	

Shëndetësia dhe mirëqenia sociale					
Programi/projekti	Shuma € 2020 (vitin e 1)	Shuma € 2021 (vitin e 2)	Shuma € 2022 (vitin e 3)	Prioritetet strategjike	
Renovimi i QMF-ve, instalimi i ngrohjeve	70 000	80 000	80 000	Në sektorin e	

	Teknologji informative	20 000	300 000	35 000	shëndetësisë synohet përmirësimi i shëndetit të popullatës nëpërmjet promovimit të mënyrave të shëndetshme të jetesës dhe sigurimit të shërbimeve cilësore shëndetësore me qasje të lehtë dhe të barabartë dhe me kosto-efektive.
	Ndertimi i QMF-se ne Vushtrri	150 000			
	Pajisje mjekësore	50 000	50 000	50 000	
	Furnizim me inventar	30 000	30 000	30 000	
	Veture per sherbimet shendetesore te terrenit	25 000	25 000	25 000	
	Rregullimi i kendeve te vaksinimit	15 000	10 000	10 000	
	Rregullimi i hapsirave të QPS	5 000	10 000	10 000	

<b>Shërbimet Sociale</b>				
<b>Programi/projekti</b>	<b>Shuma € 2020 (vitin e 1)</b>	<b>Shuma € 2021 (vitin e 2)</b>	<b>Shuma € 2022 (vitin e 3)</b>	
Mirëmbajtja e objektit të QPS-së	3,000			

<b>Shërbimet rezidenciale</b>				
<b>Programi/projekti</b>	<b>Shuma € 2020 (vitin e 1)</b>	<b>Shuma € 2021 (vitin e 2)</b>	<b>Shuma € 2022 (vitin e 3)</b>	
Renovimi qendrës rezidenciale	20,000	20,000	20,000	

<b>Projektet e propozuara</b>					
<b>Kultura, rinia dhe Sportet</b>					
<b>Nr.</b>	<b>Projektet</b>	<b>Shuma €</b>	<b>Shuma €</b>	<b>Shuma €</b>	<b>Prioritetet</b>

		<b>2020 (vitin e 1)</b>	<b>2021 (vitin e 2)</b>	<b>2022 (vitin e 3)</b>	<b>strategjike</b>
1.	Vazhdimi i ndertimit të Qendrës së Kultures	148.133			
2.	Vazhdimi i punimeve në palestren sportive “Jeton Terstena TOTA”, ngrohja qendrore dhe ventilimi	60.000			
3.	Renovimi i tualeteve, ndrimi i parketit, ngjyrosja e hapsirës së brendshme (konstrukcioni nga druri), në palestrën e sportit “Jeton Terstena TOTA”	60.000			
4.	<i>Renovimi i tribunave në stadiumin e futbollit “Ferki Aliu”</i>	65.000			
5.	Renovimi i dy fushave ansore te stadiumit, zhveshtoret, tualetet, shtrirja e gomës në stadiumin “Musa Abazi”	70.000			
6.	Ndertimi i një fushe të volejbollit nga rëra në oborrin e palestrës sportive “Jeton Terstena TOTA”	11.000			
7.	Ndertimin e fushës së tenisit në oborrin e palestrës sportive “Jeton Terstena TOTA”	20.000	7.000		
8.	Ndertimi i fushese së basketbollit në oborrin e palestrës sportive “Jeton	10.000	10.000		
9.	Ndërtimi i pllakës përkujtimore për martirët e 22 Majit	3,500			
	<b>TOTALI</b>	<b>447,633</b>	<b>17,000</b>		

## VIII. Analiza gjinore

Buxhetimi i përgjithshëm gjinor tashmë është pjesë e kornizave legislative të vendit e cila kërkon nga të gjitha institucionet publike, të integrojnë barazinë gjinore në projektimin e politikave zhvillimore dhe në shpenzimin e parasë publike. Buxhetimi i përgjithshëm gjinor pranon se gratë dhe burrat kanë marrëdhënie të ndryshme me ekonominë. Po ashtu, kjo ka të bëjë edhe me faktin

se nëse duam të arrijmë progres të qenësishëm për barazinë gjinore, politikat pa buxhet nuk mjaftojnë. Buxheti i përgjithshëm gjinor kërkon që buxhetet t'u përgjigjen më mirë nevojave të njerëzve. Qëllimi është të integrohet aspekti gjinor si një kategori, analizë dhe kontroll në procesin buxhetor. Logjika mbi të cilën mbështetet buxheti i përgjithshëm gjinor është se si të gjitha politikat shtetërore buxheti i prek ndryshëm gratë dhe burrat për shkak të nevojave dhe roleve të tyre mbi baza gjinore. Synimi i buxhetimit të përgjithshëm gjinor është:

-Të sigurojë që masat e buxhetit të shtetit (si nga ana e shpenzimeve ashtu edhe nga ana e të ardhurave të buxhetit) të marrin në konsideratë nevojat e ndryshme të grave, burrave, të vajzave dhe djemve;

-të sigurojë që buxheti kontribuon në zvogëlimin e pabarazisë gjinore; dhe

-të realizojë shërbime publike në mënyrë që të rritet barazia gjinore.

Komuna nuk ka përgatitur një buxhet të përgjithshëm gjinor të detajuar, por është përpjekur për të vlerësuar sesi shpenzimet kapitale janë ndarë për të adresuar çdo pabarazi gjinore në planifikimin e ardhshëm buxhetor. Ne kemi analizuar numrin e grave dhe burrave, djemve dhe vajzave në kuadër të komunës dhe e kemi paraqitur këtë informacion në tabelat e mëposhtme:

Tabela 11:

Kategoria	Shifrat sipas regjistrimit të popullsisë 2011	%	Parashikimi për vitin 2020(varianti i mesëm)	%
Gra	17,541	<b>25.11</b>	18,583	25.54
Burra	15,891	<b>22.74</b>	16,366	22.49
Vajza	16,325	<b>23.36</b>	17,220	23.67
Djem	20,113	28.79	20,593	28.30
Popullata e përgjithshme	69,870	100	72,762	100

## IX. Informacionet sipas programeve

Zyra e Kryetarit

**Misioni:** Misioni është që kjo zyrë të jetë e përgjegjshme dhe llogaridhënëse për të arritur rezultatet që avancojnë interesat e qytetarëve.

**Vizioni:** Ofrimi i këshillave për Kryetarin e komunës, gjegjësisht ekzekutivin e komunës

Duke ditur se posti i Kryetarit të komunës, përkatësisht qeverisë komunale kërkon angazhim dhe përgjegjësi të veçantë për t'u ballafaquar me probleme të ndryshme, si dhe duke pas parasysh gjendjen jo të mirë ekonomike dhe sociale në komunën tonë, vizioni ynë është që organet e komunës t'i kryejnë obligimet e tyre dhe përgjegjësitë në pajtim me ligjet, rregulloret, vendimet e kuvendit dhe aktet tjera në fuqi, gjegjësisht për angazhim të shtuar dhe efektshmëri sa më të madhe në punë, si dhe për ofrim të shërbimeve sa më cilësore të qytetarëve, për një jetë më të mirë, perspektivë dhe prosperitet në të ardhmen.

Zyra e Kuvendit

**Misioni:** Për t'i shërbyer qytetarët e komunës, duke siguruar procedim me kohë për miratimin e duhur të propozimeve nga Kryetari i komunës, respektivisht qeverisë komunale, në kuvendin e komunës në përputhje me detyrimet ligjore.

**Vizioni:** Për të siguruar shqyrtimin në afat ligjor dhe miratimin e politikave të komunës, duke përfshirë edhe legjislacionin brenda kompetencave ligjore të komunës, siç janë: Statuti i komunës, rregulloret komunale, planifikimi buxhetor etj. e gjithë kjo në interes të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.

### **Shërbimet publike, mbrojtja civile dhe emergjencat**

**Misioni:** Një komunë e pastër dhe e sigurt për të gjithë qytetarët.

**Vizioni:** Për të përmbushur obligimet statutores të drejtorisë dhe adresimin e nevojave të qytetarëve tanë në fushën e rrjetit komunal rrugor, ujit dhe infrastrukturës së mbeturinave, hapësirave të gjelbra, shërbimeve emergjente dhe të sigurisë. Ne do të bëjmë dhe arrijmë këtë duke zbatuar mirëmbajtjen e planifikuar dhe përmirësimin e infrastrukturës së rrugëve, hapësirave publike (duke përfshirë parqet dhe varrezat), furnizimin me ujë dhe menaxhimin e ujërave të ndotura. Ne gjithashtu do të sigurojmë një plan të duhur që është në vend dhe zbatohet për mbrojtjen nga zjarri dhe emergjencat tjera.

### **Shëndetësia dhe mirëqenia sociale.**

**Misioni:** Një komunë ku popullata ka qasje më të përballeshme dhe efektive në shërbimin e kujdesit parësor shëndetësor, mbrojtjes dhe asistencës sociale.

**Vizioni:** Në drejtorinë tonë ne punojmë për të zbatuar legjislacionin përkatës shëndetësor, për të siguruar që shërbimet e mëposhtme primare shëndetësore për të gjithë qytetarët ofrohen në fushat e mjekësisë familjare, stomatologjisë, farmacisë, shërbimet laboratorike dhe kujdesin mjekësor emergjent. Ne i ofrojmë këto shërbime duke punësuar staf profesional dhe duke e trajnuar stafin mjekësor që vepron në Qendrën kryesore të mjekësisë familjare . Përveç kësaj, ne po ashtu do të punojmë për të siguruar nivelet e duhura të higjienës që nga kryerja e inspektimeve sanitare për ujin e pijshëm, bizneset prodhuese, përpunimin ose shitjen e ushqimit dhe atyre kompanive që merren me trajtimin e mbeturinave. Gjithashtu synojmë për të siguruar mbështetje të shërbimit social në pikat më të rrezikuara të bashkësisë sonë dhe këtë e bëjmë përmes identifikimit të rasteve sociale, dhe duke vlerësuar nevojën rast për rast.

Indikatori	2020	2021	2022
% e fëmijëve nën moshën 1 vjeçare që e përfundojnë rrethin e parë të imunizimit	95%	96%	98%
Renovimi i objekteve shëndetësore; % e zbatimit të planit 3 vjeçar për përmirësimin e objekteve shëndetësore	100%	100%	100%
Raporti i numrit të doktorëve me numrin e qytetarëve	1 doktor në 2500 banorë	1 doktor në 2300 banorë	1 doktor në 2000 banorë
Numri i fëmijëve shkollor që kryejnë kontrole dentare përmes vizitave në shkolla, vetëm gjatë kontrolleve sistematike të klasave të para që kryhen çdo vit.	1070 nxënës	1100 nxënës	1200 nxënës
Numri i shkollave që marrin pjesë në fushatën për vetëdijesimin dentar, vetëm gjatë kontrolleve sistematike të klasave të para që kryhen çdo vit	1070 nxënës	1100 nxënës	1200 nxënës

## Planifikimi Urban dhe Mjedisit

**Misioni:** Mjedis më tërheqës natyror dhe përdorim më efektiv i tokës dhe ndërtesave në Kosovë.

**Vizioni:** Planifikon zhvillimin hapësinor dhe urbanistik, përcjell dhe studion zhvillimin hapësinor brenda territorit të komunës (sipas metodologjisë bashkëkohore);

- Harton programe, planin zhvillimor të komunës, planin zhvillimor urban, dhe planet rregulluese urbane të vendbanimeve dhe tërësive tjera;
- Ofron sugjerime dhe mendime lidhur me procedurën për miratimin e tyre dhe propozon realizimin e tyre;
- Mbledh, përpunon dhe plotëson dokumentacionin e zhvillimit hapësinor, në harmoni me Ligjin për planifikimin hapësinor dhe dispozitat tjera të nxjerra në bazë të tij;
- Bashkëpunon me të gjitha subjektet pjesëmarrëse në planifikimin dhe zhvillimin e qytetit dhe të komunës për hartimin e planeve hapësinore;
- Merret me planifikimin urban dhe rural të komunës dhe të shfrytëzimit të tokës;
- Bashkëpunon rreth konceptit të zgjidhjeve dhe përmbajtjeve të planeve rregulluese urbane;

- Përcjell planifikimin urbanistik dhe projektimin, si dhe merret me zbatimin e tyre;
- Përgatit plane të detajuara urbanistike, projektet urbanistiko-arkitektonike për lagje dhe tërësi të caktuara të qytetit dhe komunës;
- Harton programe, detyra projektuese me ndihmën e ekspertëve të përzgjedhur për organizimin e konkurseve urbanistiko-arkitektonike në nivel vendor dhe ndërkombëtar;
- Përgatit dhe ofron informacione bazë dhe dokumente për përgatitjen, miratimin apo ndryshimin e planeve hapësinore, urbanistike, rregulluese dhe planeve të detajuara të qytetit dhe të komunës;
- Propozon dhe zbaton rregullativën ligjore nga lëmi i planifikimit hapësinor: Planit zhvillimor të komunës, Planit zhvillimor urban, Planit rregullues urban, si dhe rregullativën nga lëmi i ndërtimeve investive;
- Përcakton kushtet urbanistike dhe arkitektonike për hartimin e dokumentacioneve investivo-teknike, për ndërtimin e objekteve lidhur me realizimin e projekteve kryesore urbanistike dhe zgjedhjet e tyre arkitektonike;
- Propozon dhe miraton kriteret për vendosjen e objekteve të përkohshme, pajisjeve dhe elementeve mikro-urbane në territorin e qytetit dhe komunës;
- Merret me hartimin e legjislacionit, ekspertizave analitike, veprimtarive të tjera në fushat e caktuara të planifikimit hapësinor dhe urban;
- Propozon dhe zbaton programin për hapësirën e komunës;
- Jep pëlqime për ndërtimin e objekteve të rëndësisë lokale dhe zhvillimeve të tjera;
- Organizon dhe kontrollon dokumentacionin teknik;
- Organizon dhe cakton grupin profesional për mbikëqyrje, pranime teknike të objekteve ndërtimore dhe shërbime tjera përkatëse;
- Lëshon vendime dhe vërtetime për gjendjen e objekteve ekzistuese;
- Konstaton dhe delegon informatat për objektet e ndërtuara në mospërputhje me ligjet ndërtimore, standardet dhe dokumentacionet urbanistike në fuqi;
- Jep leje për përdorimin e objekteve të përfunduara;
- Inicon programe për ndërtimin e infrastrukturës dhe objekteve kapitale në territorin e komunës;
- Bashkëpunon me subjektet përkatëse komunale në fushën e rregullimit të tokës ndërtimore;
- Propozon krijimin e zonave të tokës së ndërtimit dhe përpunon lokacionet për dhënien e tokës në shfrytëzim;
- Zbaton programet e sektorëve të tjerë të Administratës komunale, në fushën e ndërtimit të infrastrukturës dhe objekteve kapitale, si dhe vendimet komunale nga përgjegjësia e kësaj drejtorie;
- Përgatit propozimet e rregulloreve dhe akteve tjera nga lëmi i ndërtimit, planifikimit, projektimit dhe rregullimit hapësinor;
- Udhëzon dhe orienton subjektet nga fusha e ndërtimit, bashkëpunon me subjektet udhëheqëse dhe personat juridikë nga fusha e ndërtimit, ofron të dhënat dhe informata të tjera bazike profesionale të nevojshme për punën e udhëheqjes komunale;
- Koordinon dhe kryen punët procedurale nga lëmi i ndërtimit;
- Kryen detyra të tjera të deleguara nga ligji dhe rregulloret tjera në fuqi;
- Harton projektprogramin për vlerësimin e gjendjes ekzistuese të tokës ndërtimore të komunës;
- Propozon dhe zbaton programin e veçantë për rregullimin e gjendjes ekzistuese të tokës ndërtimore të komunës;
- Organizon dhe trajnon grupet profesionale dhe kapacitetet njerëzore për procedurën e legalizimit.
- Organizon dhe cakton grupin profesional për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave (dokumentacioneve) për legalizim;
- Kontrollon dokumentacionin teknik në harmoni me ligjet ndërtimore, standardet, dokumentacionet urbanistike në fuqi, si dhe me rregulloren dhe manualin për legalizim;

- Shqyrton programe për ndërtimin e infrastrukturës dhe objekteve kapitale në tërësi të hapësirave ilegale;
- Koordinon dhe kryen punët procedurale nga lëmi i ndërtimeve ilegale;
- Kryen edhe detyra të tjera në pajtim me dispozitat ligjore.

<b>Indikatori</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>
Koha për lëshimin e lejes ndërtimore	30-45	30-45	30-45
% e lejeve të lëshuara brenda afatit ligjor	70	80	85

### **Bujqësi, pylltari dhe zhvillimi rural**

**Misioni:** Për të krijuar ambient tërheqës, bashkësi familjare ekonomike të qëndrueshme në zonat rurale, duke përfshirë të gjitha grupet pa dallim etniteti, feje apo gjinie për një ambient të qëndrueshëm socio-ekonomik dhe duke promovuar praktikatat e mira bujqësore.

**Vizioni:** Qëllimi ynë kryesor është për të siguruar që numri maksimal i familjeve në zonat e fshatrave dhe sidomos fermat familjare do të zhvillohen dhe mbajnë një bazë ekonomike të qëndrueshme brenda komunës. Ne planifikojmë dhe ta bëjmë këtë duke mbrojtur tokën bujqësore përmes mbajtjes së një shënimi/të dhënave të sakta të përdorimit të tokës bujqësore dhe pronësisë së këtyre pronave. Ne do të bashkëpunojmë me bankat komerciale, për të shqyrtuar format e kreditimit për fermerët dhe për të stimuluar dhe promovuar blerjet blegtorale dhe zhvillimin bujqësor në këto mjedise. Ne gjithashtu bashkëpunojmë ngusht me ekspertë të IADK që të ofrojmë këshilla për fermerë për të zhvilluar kapacitetet prodhuese, ngritjen e fuqisë së tyre konkurruese në treg, duke promovuar praktikatat më të mira bujqësore. Ne do të promovojmë mbrojtjen e mjedisit tonë natyror dhe të zbatojmë legjislacionin përkatës në fushën e mjedisit dhe ruajtjes së pyjeve.

<b>Indikatori</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>
% e tokës bujqësore që është duke u kultivuar	caku për vitin 2020	caku për vitin 2021	caku për vitin 2022
5986 ha	6083 ha	6154 ha	6250 ha



## Arsimi dhe Shkenca

**Misioni:** Çdo personi do duhet t'i mundësohet arsimit, sporti dhe kultura nëpërmjet përvojave të të nxënësit pozitiv dhe do të stimulohet për arritjet e tij / saj të plota, veprime të cilat do ju japin atyre besim dhe do të gjejnë vet përmbushje me atë që merren.

**Vizioni:** Qëllimi ynë është që të sigurojmë qasje të barabartë për të gjithë fëmijët brenda komunës, në sistemin e arsimit cilësor, parashkollor, fillor dhe atë të mesëm. Ne gjithashtu do të mbështesim sigurimin e edukimit të mëtejshëm për të rriturit dhe për ta bërë këtë kemi siguruar zbatimin e rregullores kombëtare, legjislacionin e duhur arsimor dhe politikat gjegjëse si rezultat. Po ashtu marrim pjesë në përzgjedhjen e stafit dhe drejtorëve të shkollave për të siguruar se profesionistët dhe të kualifikuarit janë të punësuar për të mësuar qytetarët tanë, të rinjtë dhe të moshuarit dhe njëherit i mbajmë të gjitha shënimet e nevojshme komunale të arsimit dhe statistikave për të matur nivelin e cilësisë së arsimit që ofrohet nga komuna. Gjithashtu komunikojmë hapur me publikun për të gjitha çështjet që lidhen me politikën e arsimit dhe procesit përbrenda komunës, si dhe bëjmë promovimin e sportit dhe kulturës me organizimin e ngjarjeve sportive dhe kulturore, përkrahjen e organizatave sportive dhe drejtimin e qendrës komunale të kulturës.

<b>Indikatori</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>
% e fëmijëve që arrijnë moshën për të filluar shkollën	8 %	7.93 %	7.91%
% e nxënësve që kalojnë provimin shtetëror	53.95 %	54.33%	55.05%
% e shkollave që kanë kaluar nga sistemi me 3 ndërrime në sistemin me 2 ndërrime	100 %	100 %	100 %
Raporti i numrit të mësuesve me numrin e fëmijëve parashkollorë, fillorë dhe të mesëm.	Niveli 0, 1:17.4 Niv. 1 dhe 2 1:16% Niveli 3, 1:17	Niveli 0, 1:17.4 Niv. 1 dhe 2 1:16% Niveli 3, 1:17	Niveli 0, 1:17.4 Niv. 1 dhe 2 1:16% Niveli 3, 1:17

## Administrata dhe Personelit

**Misioni:** Për të qenë më të mirë në ofrimin e shërbimeve administrative - të kuptuarit se ofrimi i veprimeve dhe shërbimeve tona dhe suksesi ynë është i lidhur me kënaqësinë e qytetarëve.

**Vizioni:** Ne kemi për qëllim të ofrojmë shërbime cilësore për qytetarët tanë në një kohë dhe në mënyrë efikase nëpërmjet Qendrës së shërbimit të qytetarëve. Llojet e shërbimeve që ne ofrojmë janë regjistrimet e qytetarëve dhe lëshimi i certifikatave, duke u siguruar mbështetje administrative dhe këshilla për të gjitha drejtoritë tjera komunale dhe Kuvendin dhe për t'iu mundësuar atyre që t'i arrijnë objektivat dhe synimet e tyre. Lloji i mbështetjes logjistike që ne ofrojmë përfshin ruajtjen, transportin, postën, inventarizimin, sigurinë, përkthimin e dokumenteve zyrtare, mirëmbajtjen e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe mirëmbajtjen e ndërtesave, kurse për të përmirësuar transparencën për qytetarët tanë, ne mirëmbajmë dhe e freskojmë rregullisht faqen e internetit të komunës

Indikatori	2019	2020	2021
Lëshimi i dokumenteve të gjendjes civile	60,000	60,000	60,000
Numri i kërkesave të pranuar nga QSHQ	70,000	70,000	70,000

## Buxheti dhe financat

**Misioni:** Arritja e niveleve më të larta të ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit në menaxhimin e fondeve komunale.

**Vizioni:** Nëpërmjet planifikimit të duhur dhe menaxhimit të resurseve komunale, ne përpiqemi që të promovojmë vlerën për ofrimin e të gjitha shërbimeve për qytetarët e Vushtrrisë. Ne mbikëqyrim planifikimin dhe zbatimin e buxhetit komunal për të siguruar pajtueshmërinë me të gjithë legjislacionin e financave, statutit dhe rregulloreve tjera përkatëse. Ky veprim përfshin zbatimin e rregullores mbi tarifatat dhe pagesat, veprime që lidhen me mbledhjen e tatimit në pronë. Ne gjithashtu do i përgatitim të gjitha raportet financiare dhe llogaritë vjetore në përputhje me kërkesat statutores komunale.



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kuvendi i Komunës



Datë/a:	18.03.2020
Për:	Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë
Propozues:	Kryetari i Komunës, Xhafer Tahiri
Hartues:	Drejtoria për Shërbime Publike, Refik Maloku
Tema:	Akt përcjellës për Draft - Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë

Në vijim të këtij akti përcjellës, ju dërgojmë Draft - Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave të Komunës së Vushtrrisë, e cila i është nënshtruar diskutimit publik konform vendimit të kuvendit të komunës, ku janë dhënë vërejtje dhe propozime nga akterë të ndryshëm që i referohen këtij dokumenti, të cilat janë të evidentuara në procesverbalin nga diskutimi publik.

Bashkangjitur me këtë akt gjeni Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë, (shqyrtimi i dytë).

Në bazë të nenit 12, al.2, pika c, nenit 17, pika f, nenit 40 al.2, pika a dhe g, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 8, pika a, nenit 15 pika f, dhe nenin 19 al.1, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, dispozitat e neneve 15 dhe 34 të Ligjit nr. 04/L – 60 për Mbeturina, dhe nenit 41.2, shkronja c të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur \_\_\_\_\_ 2020 miratoi këtë:

## Rregullore

### Për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë

#### Neni 1

##### Qëllimi

Kjo rregullore trajton çështjen e menaxhimit të mbeturinave komunale, përcakton vlerën (shumën) e taksës për mbeturina, me qëllim që të krijohet një sistem i qëndrueshëm financiar mbi menaxhimin e mbeturinave.

#### Neni 2

##### Fushëveprimi

Kjo Rregullore definton kushtet për menaxhimin e integruar të mbeturinave për të zvogëluar sasinë që deponohet, shkarkimin, grumbullimin, transportimin dhe deponimin. Gjithashtu në kuadër të fushë veprimtarisë bënë pjesë edhe ndarja dhe aktivitetet e riciklimit, me qëllim të ruajtjes (mbrojtjes) së mjedisit jetësor në tërë territorin e Komunës së Vushtrrisë.

#### Neni 3

##### Përkufizimet

#### 1. Përkufizimet në këtë rregullore kanë këtë domethënie:

- 1.1 **Mbeturina** - substancë apo objekt që prodhuesi - zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedh ose është i detyruar ta hedh.
- 1.2 **Menaxhimi i mbeturinave** – (në tekstin e mëtejshëm i referohemi MM), aktivitetet për evitimin, reduktimin e prodhimit të mbeturinave, ndikimit të tyre në mjedis dhe në shëndetin e njeriut, mbledhjen, transportin, trajtimin, ripërdorimin, përpunimin, riciklimin dhe deponimin përfundimtar të mbeturinës, përfshirë monitorimin dhe kujdesin edhe pas kryerjes së tyre.

- 1.3 Operatori** – personi juridik i cili në përputhje me dispozitat e ligjit për menaxhimin e mbeturinave, menaxhon, kontrollon dhe është përgjegjës për objektet - pajisjet e mbeturinave, si dhe është i autorizuar të marrë vendime në lidhje me funksionet ekonomike ose teknike të pajisjeve - objekteve.
- 1.4 Licenca për menaxhimin e mbeturinave** - leje me shkrim e cila lëshohet me vendim të Ministrisë, me të cilën vërtetohet se janë plotësuar kushtet për ushtrimin e veprimtarisë sipas Ligjeve në fuqi.
- 1.5 Person** - person fizik ose juridik i cili është i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi, në proceset për menaxhimin e mbeturinave.
- 1.6 Konsumatori** – person fizik dhe juridik të cilëve u ofrohen shërbime për mbeturinat.
- 1.7 Ri-përdorimi** – përdorim i serishëm përmes së cilit çdo produkt apo komponentë e cila nuk është mbeturinë, përdoret përsëri për të njëjtin qëllim.
- 1.8 Riciklimi** - çdo operim të përpunimit nga i cili materialet mbeturinë janë rikthyer në produkte, materiale, substanca qoftë si origjinale apo për qëllime tjera. Kjo përfshinë rikthimin e materialeve organike por nuk përfshinë përfitimin e energjisë dhe ripërpunimin në materiale që përdoren si karburante apo për operimet e mbulimit të mbeturinave;
- 1.9 Mbledhja** – grumbullim i mbeturinave duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe magazinimin e mbeturinave për qëllime të bartjes deri në objekti për trajtim ose deponim të mbeturinave.
- 1.10 Mbledhja e selektuar** - nënkupton mbledhjen, kur grumbullimi i mbeturinave bëhet në mënyrë të ndare në lloje, të klasifikuara sipas natyrës dhe pajisjeve për të lehtësuar trajtimin specifik.
- 1.11 Gjenerues i mbeturinës** – çdo person, veprimtaria e të cilit krijon/prodhon mbeturinë ose operime tjera të cilat rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen e mbeturinës.
- 1.12 Zotëruesi i mbeturinës** - gjeneruesi i mbeturinës apo personi që e posedon mbeturinën.
- 1.13 Mbeturina komunale** - mbeturina nga amvisëritë, dhe mbeturina nga aktivitetet tjera të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë.
- 1.14 Mbeturina e parrezikshme** - mbeturina që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut si dhe nuk kanë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme.
- 1.15 Mbeturina komerciale** - mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industriale.
- 1.16 Mbeturina inerte** - mbeturina të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik dhe biologjik në vendet ku janë deponuar si mbeturinat që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin

dhe shëndetin e njeriut, ku i tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës (mbetjet ekotoksike) duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

**1.17 Mbeturinë e vëllimshme** - mbeturina me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, grumbullimi, transportimi dhe largimi i të cilave bëhet në mënyrë të veçantë.

**1.18 Qendra grumbulluese** – Lokacioni për grumbullimin e mbeturinave të ndara sipas llojeve të tyre.

**1.19 (3R)** – reduktim, ripërdorim, riciklim

#### Neni 4

##### **Mbledhja, grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave**

1 Mbledhja, grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave bëhet nga personi i licencuar dhe i kontraktuar nga komuna, prej gjeneruesit e deri në deponinë e mbeturinave.

2 Mbeturinat e rrezikshme, para se të mblidhen dhe transportohen, klasifikohen sipas llojeve të tyre, pastaj mblidhen dhe transportohen.

3 Nëse gjatë transportimit të mbeturinave ndodhë ndotja, transportuesi është i detyruar që vendin e ndotur ta kthej në gjendje të mëparshme.

#### Neni 5

##### **Menaxhimi i mbeturinave nga Komuna**

**1 Përgjegjësitë e Komunës në lidhje me menaxhimin e mbeturinave janë:**

1.1 Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale.

1.2 Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar.

1.3 Kontraktimi i shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave.

1.4 Formimi i sektorit për menaxhimin e mbeturinave, në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

1.5 Monitorimi dhe udhëzimi për ofruesit e shërbimeve për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave bëhet nga Sektori për menaxhimin e mbeturinave.

1.6 Të bëjë monitorimin mjedisor të qendrës së paketimit të mbeturinave të riciklueshme, e cila është ndërtuar në fshatin Bukosh.

- 1.7 Të identifikoj dhe evitojë pikat ilegale të mbeturinave.
- 1.8 Përcaktimi i lokacioneve të reja dhe llojit të kontejnerëve bëhet në bashkëpunim me operatorin dhe palët e treta.
- 1.9 Promovimi i reduktimit të sasisë së mbeturinave (përmes metodave të 3R, ndarjes në burim dhe kompostimit shtëpiak).
- 1.10 Ngritja e vetëdijes publike - pjesëmarrja aktive e qytetarëve në zbatimin e Planit të menaxhimit të mbeturinave.
- 1.11 Planifikimi buxhetor për funksionimin e menaxhimit të mbeturinave.
- 1.12 Faturimi vjetor i taksës për mbeturina, organizimi dhe shpërndarja e tyre.
- 1.13 Shqyrtimi ankesave dhe parashtrësive të paraqitura nga personi fizik dhe juridik lidhur me faturimin për mbeturina.
- 1.14 Përcaktimi i taksës dhe mënyra e arkëtimit të mjeteve financiare.
- 1.15 Dorëzimi i Raportit në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për menaxhim të mbeturinave çdo 31 mars të vitit pasues.
- 1.16 Sigurimi i kushteve të barabarta për veprim për operatorët publik dhe privat.

## **Neni 6**

### **Të drejtat dhe detyrat e gjeneruesve të mbeturinave**

1. Secili gjenerues i mbeturinave është i obliguar të përfshihet në sistemin e menaxhimit të mbeturinave dhe ka të drejtë qasjeje në shërbimin e ofruar.
2. Secili gjenerues i mbeturinave ka të drejtë ankese ndaj mos ofrimit të shërbimit.
3. Secili gjenerues i mbeturinave duhet të respektoj rregullat e shkarkimit të përcaktuara sipas planit lokal të menaxhimit të mbeturinave.
4. Secili gjenerues duhet të bëjë përpjekje për zvogëlimin e sasisë së mbeturinave (përmes formave të përcaktuara në nenin 5 paragrafi 9 të kësaj rregulloreje).
5. Secili gjenerues i mbeturinave duhet të paraqes ndryshimin e të dhënave ( siç janë: shitja e pronës, trashëgimia dhe dëshmitë tjera relevante).
6. Regjistrimet e reja të amvisërive në sistem bëhen në bazë të këtyre kritereve:

- 6.1 kontrata e shitblerjes
  - 6.2 blerësi duhet të regjistrohet në sistem, nëse nuk është i regjistruar paraprakisht nga data e nënshkrimit të kontratës, ndërsa shitësit vetëm adresa i ndryshohet.
  - 6.3 regjistrimi i njehsorit të rrymës elektrike.
  - 6.4 konfirmimi i pagesës së faturës për mbeturina për vendbanimin paraprak.
  - 6.5 Dokumenti identifikues.
- 7. Për shërbimin e ofruar, gjeneruesi obligohet të paguaj taksën e shërbimit.
  - 8. Secili gjenerues i mbeturinave, duhet të bashkëpunoj me autoritetin publik, për të siguruar një mjedis të pastër.
  - 9. Secili gjeneruesi i mbeturinave është i obliguar të regjistrohet në listat e shërbimit të konsumatorëve për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave.
  - 10. Gjeneruesit e mbeturinave detyrohen që mbeturinat t'i ndajnë dhe t'i vendosin sipas sistemit të përcaktuar në planin e operimit të përcaktuar nga komuna.
  - 11. Ndërmarrjet prodhuese, ndërtuese dhe tjera në cilësinë e gjeneruesve të mbeturinave, obligohen që Komunës së Vushtrrisë, t'ia dorëzojnë planin e menaxhimit të mbeturinave, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

## **Neni 7**

### **Taksa për mbeturina**

- 1. Taksa për mbeturina, faturohet dhe inkasohet nga komuna.
- 2. Shpërndarja e faturës së mbeturinave bëhet bazuar në sistemin e të dhënave, kurse fatura vjetore i dorëzohet gjeneruesit deri me 31 Mars të vitit kalendarik.
- 3. Gjeneruesi i mbeturinave obligohet që të paguaj faturën e taksës së mbeturinave, për çdo muaj të vitit ose me këste si më poshtë:
  - 3.1 Kësti i parë Janar – Mars;
  - 3.2 Kësti i dytë Prill – Qershor;
  - 3.3 Kësti i tretë Korrik- Shtator, dhe
  - 3.4 Kësti i katërt Tetor – Dhjetor.



4. Paguesa e taksës për mbeturina, në shumën deri në dhjetë (10,00) € mund të bëhet në arkën e komunës në Qendrën e Shërbimit me Qytetar, kurse në shumën mbi dhjetë (10,00) €, bëhet në institucionet financiare për pagesa.
5. Familjet të cilat ngarkohen me tarifë të energjisë elektrike në shumën totale prej pesëmbëdhjetë (15.00 €) të njëjtat obligohen për të paguar taksën vjetore të mbeturinave në vlerën trembëdhjetë euro e njëzet cent (13.20 €). Ky paragraf vlen vetëm për qytetarët jo rezident të Komunës së Vushtrrisë.
6. Në rastet kur ndryshon çmimi i energjisë elektrike si në paragrafin 5 të këtij neni, atëherë me automatizëm do të ndryshojë çmimi i taksës vjetore të mbeturinave.
7. Për kategorizimin e obligimit vjetor vlen pasqyra vjetore e shpenzimit të energjisë elektrike, i cili prezantohet në fund të çdo viti kalendarik.
8. Secili gjenerues që banon me qira, është i obliguar të bëjë pagesën për mbeturina në emër personal dhe duhet të regjistrohet në sistemin për menaxhimin e mbeturinave, ose të dëshmojë kontratën e nënshkruar (në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit).
9. Nëse gjeneruesi i mbeturinave nuk i paguan obligimet nga këstet paraprake, atëherë i njëjti nuk do të merr shërbime komunale administrative për:
  - 9.1 Shërbimet nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër,
  - 9.2 Shërbime nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit,
  - 9.3 Shërbimet nga Drejtoria për Shërbime Publike,
  - 9.4 Shërbimet nga Drejtoria e Prokurimit.
  - 9.5 Shërbimet nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik Bujqësi dhe Pylltari.
  - 9.6 Drejtoria për Buxhet dhe Financa, me përjashtim të shërbimeve të sektorit të ofiqari së.
10. Taksa mujore për mbeturina kategorizohet si më poshtë:
  - 10.1 Konsumatorët e rregullt të amvisërisë të rregullt dhe nga diaspora:
    - 10.1.1 Përmes shërbimit me kontejnerëve të përbashkët;
    - 10.1.2 Përmes shërbimit të ashtuquajtur „derë më derë”.

10.2 Konsumatorët komercial/industrial;

10.2.1 Dyqanet e vogla Zejtare dhe Shërbyese;

10.2.2 Subjekte të mesme deri të mëdha komerciale me kosto të ulët të shërbimit;

10.2.3 Subjekte të mesme deri të mëdha komerciale me kosto të lartë të shërbimit.

10.3 Institucionet tjera:

10.3.1 Konsumatorët e vegjël institucional;

10.3.2 Konsumatorët e mesëm dhe të mëdhenj institucional;

11. Brenda çdo viti kalendarik niveli i taksës mund të rishikohet nga Drejtoria për Shërbime Publike, duke marrë parasysh shkallën e inkasimit.

12. Nëse kuvendi i komunës aprovon shkallën e përshtatshme të inkasimit të propozuar për vitin në vijim, qytetarët njoftohen para fillimit të vitit të ardhshëm fiskal.

t

13. Taksa minimale e shërbimit të grumbullimi të mbeturinave që iu ofrohet institucioneve dhe bizneseve të mëdha të kontraktohen individualisht, siç është përcaktuar, me qëllim të ruajtjes së kualitetit të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave.

## **Neni 8**

### **Detyrat dhe Përgjegjësitë e Operatorëve të kontraktuar për shërbimin e mbeturinave**

Operatorët e kontraktuar nga organi kontraktues, për ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, janë të obliguar që të veprojnë sipas kontratës dhe ligjeve në fuqi, të cilat e rregullojnë këtë fushë.

## **Neni 9**

### **Veprimet e ndaluara**

1. Me këtë rregullore ndalohen veprimet si më poshtë:

1.1 Hedhja e mbeturinave ndërtimore në rrugë, trotuare, sheshe apo mjedise publike;

1.2 Hedhja e mbeturinave të llojeve tjera në kontejnerë ose në pikat mbledhëse të mbeturinave, të cilat nuk ndahen ashtu siç është paraparë me legjislacionin në fuqi dhe aktet tjera relevante të kësaj fushe;

1.3 Hedhja e mbeturinave në hapësirat e përbashkëta brenda dhe jashtë objekteve të banimit kolektiv siç janë; ballkonet, korridoret dhe tarracat e banesave;

- 1.4 Përzierja dhe hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të destinuar për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme;
- 1.5 Hedhja e mbeturinave në rrugë nga automjetet në lëvizje;
- 1.6 Hedhja dhe deponimi i mbeturinave në hapësirat publike si në rrugë, parqe dhe në vende të tjera publike;
- 1.7 Ndërrimi i vendndodhjes së kontejnerëve, pikave ose vendeve të përcaktuara për hedhjen e mbeturinave, pa autorizim të autoriteteve komunale;
- 1.8 Djegia e mbeturinave në vende publike, kontejnerë, në pikat mbledhëse dhe ndarëse të mbeturinave;
- 1.9 Shfrytëzimi i mbeturinave si ushqim për kafshët dhe të ngjashme nga kontejnerët ose nga pikat mbledhëse të mbeturinave;
- 1.10 Shfrytëzimi i kontejnerëve publik nga bizneset, veprimtaritë ekonomike për llojet e mbeturinave që nuk përfshihen në përkufizimin “mbeturina komunale dhe komerciale”, për të cilët ekzistojnë kontejner dhe kontrata të veçanta;
- 1.11 Gërmimi, përzierja, derdhja dhe përhapja e mbeturinave të hedhura në kontejnerë, ose në pikat mbledhëse nga personat e paautorizuar;
- 1.12 Hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të mbeturinave;
- 1.13 Dërdhja apo rrjedhja e mbeturinave prej automjeteve, gjatë transportimit për në impiantet për trajtim apo për deponim në deponi të mbeturinave;
- 1.14 Ndalimi i transportimit të mbeturinave, pa mbulesë adekuate, me qëllim të pengimit të derdhjes, shpërndarjes apo rrjedhjes së mbeturinave gjatë transportimit me destinacion tek impiantet për trajtim apo në deponi të mbeturinave;
- 1.15 Ndalohet ndryshimi i mënyrës, metodave, teknikës dhe teknologjisë së largimit të mbeturinave në kundërshtim me kushtet e përcaktuara me kontratë.
- 1.16 Ndalohet hedhja në kontejnerë ose në afërsi të tyre të mbeturinave nga pajisjet elektrike, elektronike dhe të vëllimshme.

#### **Neni 10 Dispozitat Ndëshkuese**

1. Ndaj gjeneruesit të mbeturinave i cili nuk e bën pagesën e taksës për mbeturina dhe i cili nuk i përmbahet rregullave të shkarkimit, të përcaktuara sipas planit të menaxhimit të mbeturinave, do të inicohet procedurë ndëshkimore sipas ligjeve në fuqi.
2. Për shkelësit e dispozitave të kësaj rregulloreje, për veprimet e ndaluara, inspektori komunal ose zyrtari policor shqipton gjobë mandatore sipas udhëzimit administrativ 14/2015, apo gjobat tjera të përcaktuara sipas Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina.

## Neni 11

### Komisioni këshillues-monitorues

1. Komisioni këshillues-monitorues themelohet nga sektori për menaxhimin e mbeturinave-Drejtoria për Shërbime Publike, i cili vlerëson performancën e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave nga operatorët e kontraktuar.
2. Komisioni këshillues- monitorues mund të ketë më së shumti 7 anëtarë.
3. Sektori i menaxhimit të mbeturinave e propozon përbërjen e anëtarëve si më poshtë dhe miratohet nga kryetari
  - 3.1 Përfaqësues komuniteti-lagja;
  - 3.2 Ekspertë të fushave, dhe
  - 3.3 Qytetarë.
4. Detyrat e komisionit këshillues- monitorues janë:
  - 4.1 Vlerësimi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave të ofruar nga operatorët e kontraktuar;
  - 4.2 Paraqitja e opinionëve të qytetarëve lidhur me kualitetin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, dhe
  - 4.3 Raportimi për rezultatet e monitorimit dhe opinionet e qytetarëve në sektorin e menaxhimit të mbeturinave.
5. Mandati i anëtarëve të komisionit do të jetë një (1) vjeçar.
6. Pagesa e anëtarëve të komisionit për këshillim - monitorim bëhet në bazë të marrëveshjes me ta.
7. Komisioni këshillues-monitorues duhet të mbajë takime së paku njëherë në tre muaj dhe e dorëzon raportin tre mujor për gjendjen e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave te Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave.

## **Neni 12**

### **Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare**

1. Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje është edhe shtojca e cila bënë kategorizimin dhe përcaktimin e taksave.
2. Për zbatimin e kësaj rregulloreje kujdesen: kryetari i komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria për inspektime dhe njësitë përkatëse të administratës komunale.

## **Neni 13**

### **Hyrja në fuqi**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja 01 nr. 189/15 dt. 29 Shtator 2015 për menaxhimin e mbeturinave komunale.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

---

Nasuf Aliu

**Shtojca: Tarifa e taksës për mbeturina;**

1. Amvisëritë, konsumatorët e rregullt (A):

a) Zona Urbane----- 4.40 €/muaj

b) Zona Rurale ----- 4.40 €/muaj

2. Amvisëritë nga Diaspora (D):

a) Zona Urbane----- 13.20 €/vit

b) Zona Rurale ----- 13.20 €/vit

2. Tarifa e taksës së mbeturinave për biznese dhe lokale tjera afariste do të caktohet në bazë të hapësirës së objektit në m<sup>2</sup> dhe atë si më poshtë:

a) Lokalet e bizneseve me hapësirë prej 01-20 m<sup>2</sup> - 5.30 €/muaj

b) Lokalet e bizneseve me hapësirë prej 21-50 m<sup>2</sup> - 11.70 €/muaj

c) Lokalet e bizneseve me hapësirë mbi 50 m<sup>2</sup> - 23.50 €/muaj

3. Tarifa minimale për Institucionet publike dhe bizneset e shkallës më të lartë bëhen me kontraktim individual me kontraktuesin e shërbimit.


a) Kostoja e kontejnerit 1.1 m<sup>3</sup> ----- 11.50 euro/ zbrazje.

b) Kostoja e kontejnerit 7 m<sup>3</sup> ----- 50.68 euro/zbrazje.

## Arsyetim

Drejtoria për Shërbime Publike, në bazë të vendimit për diskutim publik të Draft-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturive në Komunën e Vushtrrisë, ka organizuar diskutim publik me akter të ndryshëm që i referohen këtij dokumenti. Të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet janë të evidentuara në procesverbal, të cilat kryesisht kishin të bënin me mënyrën e operimit të operatorit kontraktues, përderisa nuk kishte ndonjë ide konkrete apo përmbajtësore për të ndryshuar ndonjë nen të kësaj rregulloreje. Prandaj kërkohet që pas dëgjimit të dytë të bëhet edhe miratimi final i saj, zbatimi i së cilës do të mundësojë krijimin e një ambienti të pastër dhe një mjedisi të shëndoshë. Kjo rregullore do të paraprijë rishikimit të Planit ekzistues Komunal Pesëvjeçar 2016-2020, përmes së cilit është arritur që shërbimet bazike të grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave si shërbim prioritar për qytetarët, ti ofrojë për tërë territorin e Komunës së Vushtrrisë. Me shtrirjen e shërbimit në tërë territorin e komunës, janë krijuar kushtet për vazhdimin e procesit të ndarjes së mbetjeve, ku aktualisht mbeturinat i ndajnë rreth 1200 ekonomi familjare dhe institucionet e arsimit. Me qëllim të rregullimit të çështjeve të hapura dhe të identifikuar gjatë implementimit të planit komunal, për arsye të krijimit të infrastrukturës ligjore dhe ngritjes së performancës në fushën e menaxhimit të mbeturinave, Drejtoria për Shërbime Publike ka ndryshuar dhe plotësuar Rregulloren ekzistuese prandaj pas miratimit përfundimtar të kësaj Draft Rregullore për Menaxhimin e Mbeturive, do të vijojmë me rishikimin e dokumenteve tjera relevante që derivojnë nga kjo Rregullore.

Drejtori i drejtorisë

  
Refik Maloku





Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtri

**Për: Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë**

**Propozues dhe hartues: Kryetari i Komunës Xhafer Tahiri**

*Xa*

**Lënda: Propozim-Vendim**

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 2, pika "d" në lidhje me nenin 73 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 41.2, pika "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, nenit 8, paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_ 2020, mori këtë:

#### **VENDIM**

#### **PËR FORMIMIN E PANELIT PËRZGJEDHËS PËR ANËTARËSIM NË KOMITETET KONSULTATIVE**

1.Me këtë vendim formohet paneli përzgjedhës për anëtarësim në komitetet konsultative të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë në këtë përbërje:

- 1.1 \_\_\_\_\_, anëtar i kuvendit;
- 1.2 \_\_\_\_\_, anëtare e kuvendit;
- 1.3 \_\_\_\_\_, anëtar i kuvendit;
- 1.4 \_\_\_\_\_, anëtar i ekzekutivit;
- 1.5 \_\_\_\_\_, nga shoqëria civile.

2. Paneli përzgjedhës i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të ketë për obligim intervistimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve, si dhe do t'i propozojë kuvendit listën me kandidatë për anëtarësim në komitetet konsultative.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: paneli i cekur në pikën 1 të këtij vendimi dhe Sekretaria e kuvendit.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Nasuf Aliu**

**Kryesuesi i Kuvendit**



## Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë ka marrë vendim për shpalljen e konkursit për anëtarësim në komitetet konsultative, pasi që komiteteve të kaluara iu ka skaduar mandati. Themelimi i komiteteve konsultave është obligim ligjor që del nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna. Komitetet Konsultative janë instrument ligjor që kanë për objektiv ofrimin e këshillave dhe propozimeve profesionale për Kuvendin e komunës si trupa të tij.

*Nga të cekurat më lartë, i propozojmë Kuvendit të komunës që të aprovojë propozim-vendimin si në dispozitiv.*



**Republike e Kosovës**  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
**Komuna e Vushtrrisë**  
*Opština Vučitrn / Municipality Vushtrri*  
**Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit**



08. Nr. 198/20  
05 qershor 2020

**Nga:** Berat Sadiku, Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit  
**Për:** z. Nasuf Aliu, Kryesues i Kuvendit Komunal të Vushtrrisë  
**Lënda:** Informatë rreth procedurës së legalizimit të objekteve

Të nderuar,

Bazuar në Planin e punës së Kuvendit Komunal e cila ka të bëjë me Informatën rreth procedurës së Legalizimit të objekteve ju njoftojmë se me hyrjen në fuqi të Ligjit për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje Nr.06/L-024 në shtator të vitit 2018 nuk ka filluar së zbatuari ky proces pasi që Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka qenë e obliguar të hartoj aktet nënligjore që rregullojnë këtë fushën e trajtimit të ndërtimeve pa leje.

Hartimi dhe nxjerrja e akteve nënligjore nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor: Udhëzimin Administrativ MMPH-Nr.05/2019 për procedurat e ankesave për trajtimin e ndërtimeve pa leje ; Udhëzimin Administrativ MMPH-Nr.06/2019 për kërkesat themelore për shëndet dhe siguri, procedurat dhe dokumentacionin për trajtimin e ndërtimeve pa leje për kategorinë e I-rë dhe të II-të, Udhëzimin Administrativ MMPH-Nr.03/2019 për përmbajtjen dhe kërkesat për bazën e të dhënave të legalizimit si dhe Udhëzimin Administrativ MMPH-Nr.04/2019 për procedurat dhe kërkesat për rrënimin e ndërtimeve pa leje , të cilat janë nënshkruar nga Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor z. Fatmir Matoshi dhe kanë hyrë në fuqi me datën 08.07.2019.

Me hyrjen në fuqi të këtyre akteve nënligjore MMPH - Departamenti për Planifikim dhe Ndërtim ka mbajtur takime lidhur me informimin e komunave për fillimin e procesit të legalizimit të objekteve konform legjislacionit të lartcekur pjesë e së cilës kanë qenë edhe zyrtarët tanë komunal të mbajtur me 20 shtator të vitit 2019. Ndërsa Drejtoria e

Urbanizmit ka mbajtur edhe dy diskutime publike në Kuvendin Komunal për t'i informuar qytetarët lidhur me procedurat dhe rëndësinë e legalizimit të objekteve pa leje si dhe ka zhvilluar një fushatë të gjerë të vetëdijesimit të publikut përmes radios, internetit, rrjeteve sociale, njoftimeve publike dhe në forma tjera të ndryshme duke informuar për mënyrën e aplikimit për legalizim.

Duke parë volumin e madh të punëve në drejtori si dhe mungesën e stafit, ka qenë e domosdoshme rritja e stafit në drejtori ku kemi marrë 7 zyrtarë profesional me Kontratë për Shërbime të Veçanta të cilët kanë filluar punën me datën 18.02.2020.

Procesi i aplikimit për listim në regjistrin e Ndërtimeve Pa Leje (RNPL) deri në vitin 2014 është kryer në mënyrë të rregullt dhe se qytetarët kanë qenë të informuar dhe të përgjegjshëm pasi që në drejtori janë pranuar numër i madh i aplikimeve, numër i cili në tërësi ka arritur shifrën prej 9708 dhe tashmë ka fillur trajtimi i tyre dhe pranimi i kërkesave të reja.


Kërkesat e dorëzuara në mënyrë të rregullt janë regjistruar në Regjistrin e Ndërtimeve Pa Leje, QGIS dhe Intranet.

Ndërsa në fazën e dytë (II) të Legalizimit të Ndërtimeve Pa Leje e cila ishte e paraparë sipas ligjit të filloj në qershor të vitit 2015, kanë aplikuar vetëm 80 aplikues, emrat e të cilëve janë në RNPL, kurse 20 aplikime tjera nuk janë në RNPL.

Ju njoftojmë që nga data 16.03.2020 për shkak të gjendjes së pandemisë deri në fund të muajit Maj nuk kemi pasur interes të madh nga qytetarët, ndërsa me fillimin e punës me staf të plotë të drejtorisë edhe interesimi dhe aplikimi i kërkesave të qytetarëve për legalizim të ndërtimeve pa leje ka filluar dhe tashmë kemi edhe rastet e para të paisjes me çertifikata të legalizimit.

Me respekt!

Berat SADIKU



Drejtore i Drejtorisë për Urbanizëm  
dhe Mbrojtje të Mjedisit

